

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7582 E diel 8 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Kur të merr koha erë... Kur kujton se je një gjeni, kur kujton se je një mbret, je një person që mund të bësh gjithçka, kur kujton se je një genie superiore ...
Vijon në faqen 21

Nga SULEJMAN MATO

Kur të merr koha erë



Opinion i Ditës

Megjithëse kauza e shembjes së Teatrit nuk ishte e PD-së, ajo iu bashkua, dhe tani pas tërheqjes së disa figurave të spikatura të trupës së aktorëve ...
Vijon në faqen 22

Nga DRITAN HILA

Kujt i shërben djegia e mandateve të PD-së?



Përfutjesit në çdo njësi në kryeqytet

Ndërtimet pa leje, Hipoteka: 300 familjet që kanë gati tapinë

Pas legalizimit nga ALUIZNI, personat që aplikuan për certifikatë pronësie

ORNELA MANJANI

Hipoteka publikon listën me 300 persona që kanë përfutuar lejet e legalizimeve dhe që duhet t'i drejtohen Zyres së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë për të aplikuar për certifikatë pronësie. Përfutjesit...

Në faqen 6

TRAFIKANTET U MASKUAN SI TURISTE, U PIKASEN NGA GUARDIA DI FINANCA

DROGE NGA SHQIPERIA, KAPET 1 TON NE ITALI

Arrestohen 3 skafistë, 2 prej tyre nga Vlora. Mediat italiane: Malli me vlerë 10 milionë euro. Tallet Berisha: Sukses i operacionit "Forca e Krimit"



(Në foto) Droga e sekuestruar nga policia Italiane

INTERVISTA

Orjola Pampuri: PD-ja nuk hyn në zgjedhje me Ramën kryeministër

Në faqen 2

KUFIJTE DETARE

Mediat greke: Qeveria e Cipras "ngriu" paktin me Shqipërinë deri mot

Në faqen 4

AMBASADORJA E BE

Vlahutin: Teatri Kombëtar, duhet të dëgjohet zëri i qytetarëve

Në faqen 9

DURRES

"Arratiset" anija nga porti, kreu i Kapitenerisë: Ishte konflikt tregtar

Në faqen 7

ARSIMI I LARTE



Leontiev Çuçi: Master profesional në ekonomi, oferta e re e "Luarasit"

Në faqen 10

MILSO Historia, foto e bursantëve të hotel "Dajti" para nisjes në Vjenë

Kur shqiptarët studionin me bursat e Rajhut

Në brendësi: Dilema e Teatrit nga Ben Andoni. Sollzhenicini nga Kujtim Morina

Nga ARMAND PLAKA

Sot duket diçka normale. Sndoshta fare e natyrishe, por sigurisht edhe tejet emocionuese e plot dobi për këdo që arrin të përfitojë një bursë studimore apo të ketë mundësi të kryejë studime në Gjermani e Austri. Të



dyja vendet sot kontribuojnë vazhdimisht me programe bursash në mbështetje të të rinjve shqiptarë në shumë fusha studimore dhe jo vetëm. Por dikur të dyja vendet ishin një: Gjatë Luftës së Dytë Botërore ato ishin pjesë e Rajhut ...

Suplement

AKSIONI OPOZITAR INTERVISTA

Deputetja e PD: Rama ruan simbolet komuniste, shkatërron ato të kulturës, por do ta rrezojmë

Orjola Pampuri: PD nuk hyn në zgjedhje me Ramën kryeministër

"Për teatrin, zgjidhja më e drejtë, referendumi"

Valentina Madani

Orjola Pampuri, deputetja e PD-së zbardh strategjinë e opozitës për rrëzimin e qeverisë përmes protestave të pandalshme deri në arritjen e qëllimit final. Pampuri thotë për "Gazeta Shqiptare" se opozita nuk do ta ndalë aksionin e saj kundër lidhjeve të qeverisë me krimin dhe se nuk mund të hyjë në zgjedhje me Edi Ramën kryeministër. Deputetja demokrate flet edhe për hapat e mëtejshëm të opozitës kundër shembjes së Teatrit Kombëtar, për të cilin shprehet se rruga më e drejtë do të ishte një referendum, siç ndodh në të gjitha vendet demokratike. Ajo akuzon kreun e qeverisë se ende ruan simbolet komuniste të diktaturës, ndërsa po shkatërron ato të kulturës. Në betejën kundër qeverisë, PD-ja është bashkë me LSI-në, ndaj Oriola Pampuri nuk përjashton edhe mundësinë e një koalicioni mes dy partive opozitare për zgjedhjet e ardhshme lokale.

Zj.Pampuri, me shtyrjen e negociatave për vitin e ardhshëm, Shqipëria njehershë në ndëshkua, por edhe u përgëzua... U përgëzua për rezultatet e arritura, por kërkohen rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korupsionit, si dhe për të ecur përpara në reformën në drejtësi. Por realisht, kur besoni se Shqipërisë do t'i hapen negociatat me BE-në?

Unë nuk dua të jem cinike, por në rastin konkret me moshapjen e negociatave, Shqipëria u ndëshkua. Nuk shoh asnjë arsye për përgëzim në një rast të tillë. Kishite muaj që kryeministri Rama dhe ministrat e tij trumbetnin 28 qershorin, ditën kur do të kurorëzohesh suksesit i punës së tyre. Por ja që 28 qershori ishte të asgjë më shumë dhe veçse një shuplakë për qeverinë nga Këshilli i Europës. Mundeshim ne të pretendonim hapjen e negociatave



Deputetja e PD Orjola Pampuri

BASHKEPUNIMI

Bashkëpunimi
Deputetja e PD-së, Orjola Pampuri deklaroi se: "Nuk mund të ketë më asnjë bashkëpunim me krimin dhe bandat që bashkëpunon qeveria 'Rama'".

kur qeveria "Rama" nuk bëri asnjë përcapje për plotësimin e 5 kushteve që KE i vendosi për të plotësuar. Nuk kishte asnjë hap përpara as për reformën në drejtësi, as për reformën në administratë, as për korupsionin e krimin dhe organizuar, as për të drejtat e njeriut. Europa nuk mund të pranojë vende në të cilat prevalon krimi, droga, banda e përfshirja e ministrave dhe e ish-ministrave me mbështetjen e kryeministrit në të gjitha këto problematika.

A është e gatshme PD-ja të bashkëpunojë me mazhorancën për përmbytjen e kushteve të mbetura për integrimin e vendit?

Opozita është e gatshme të denoncojë e të mos lejojë më asnjë aferë korruptive të kësaj qeverie. Opozita është e gatshme të mos lejojë që ky vend të bëjë hapa prapa. Të gjitha reformat që u plotësuan për arritjen e hapjes së vizave dhe përfshirjen e Shqipërisë në NATO nuk mund t'i zhbëjnë disa individë, që sot e kanë marrë peng vendin e po e shndërrojnë atë me vendin më të varfër e me problematik të Europës. Nuk mund të ketë më asnjë bashkëpunim me krimin dhe bandat që bashkëpunon kjo qeveri. 5 vite ish-injafatshëm që kjo qeveri të plotësonë të paktën njërin

prej kushteve të KE, e jo që nuk e bëri, por vijon me idetë e veprimet destruktive në interes të bashkëpunimit të ngushtë me miqtë biznesmenë mes të cilëve ndahen qindra miliona euro në kurriz të këtij vendi e qytetarëve të këtij vendi.

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka paralajmëruar rrëzimin e qeverisë para hapjes së negociatave, por cilat janë forma dhe mënyra për të larguar qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama?

Unë me keqardhje besoj që Edi Rama nuk e do hapjen e negociatave, pasi një gjë e tillë do të penalizonte vijueshmërinë e aferave korruptive të tij. Me këto ritme ku çdo ditë zbulohet nga një plan për shpërdorim buxheti nëpërmjet PPP, koncesione, kulla e kapen tonelata droge, para nga shitja e drogës që transportohen sa nga një makinë në tjetrën, ende jam skeptike që negociatat do të diskutohen edhe në 2019-ën. Ndaj, e vetmja mënyrë që ky popull të shpëtojë një herë e mirë nga kjo varfëri e kjo zgjedhje barbare që i ka pushtuar, është largimi i Edi Ramës, si mënyra më e mirë që për këtë komb të nisë një erë e re. Ndaj, protestat e pandalura të qytetarëve, vendosmëria e opozitës për t'i shkuar deri në fund

TEATRI

"Teatri është i artistëve dhe qytetarëve, ndaj e vetmja mënyrë për një vendim të drejtë mund të ishte referendumi, siç do të ndodhte në vende të tjera demokratike", u shpreh zj.Pampuri.

kësaj kauze, do të jenë hapi radhës kundrejt kësaj qeverie totalisht të korruptuar. Tashmë kauza e opozitës nuk do të jetë më as varfëria, as droga, as bandat, as trafiqet, as teatri, por të gjitha këto të përmbledhura nën një emër të vetëm, Edi Rama.

Konkretisht, cila është strategjia e opozitës për largimin e qeverisë, përmes zgjedhjeve të parakohshme?

Opozita nuk mund të hyjë në zgjedhje me një kryeministër; i cili përpos të gjitha bëmave, paratë e drogës do i përdorë siç i përdori në 25 qershor të 2017, për të blerë votën. Zgjedhje të tilla nuk do të ketë më, ashtu sikurse Edi Rama nuk mund të vijojë më punën e tij si kryeministër. Kjo do të jetë kauza e opozitës, për zgjedhje të lira e legjitime. Nuk ka parlament legjitim me vota të blera.

Cili do të jetë hapi i parë i Intensifikimit të aksionit opozitar kundër qeverisë?

Detajet do të bëhen të ditura në javën në vijim, por tashmë aksioni qytetar e opozitar nuk do të ndalet.

A do lejojë opozita që Arta Marku nga kryeprokurore e përkohshme, të bëhet kryeprokurore e përhershme?

Arta Marku nuk e kalon vetingun, pasi me ndihmën e saj e të kryeministrit, vetingu e reforma ne drejtësi ka ngecur e po bëhet e njëanshme. Zgjedhja e saj në detyrë ishte antikushetuese, puna për kapjen e "peshqve të mëdhenj" dështoi me ndihmën e saj në bazë të urdhrave të kryeministrit. Pra, Arta Marku ngel në veting për moszbatim detyre dhe për opozitën e për këdo që beson



STRATEGJIA

"Protestat e pandalura të qytetarëve, vendosmëria e opozitës për t'i shkuar deri në fund kësaj kauze do të jenë hapi radhës kundrejt kësaj qeverie totalisht të korruptuar. Tashmë kauza e opozitës nuk do të jetë as varfëria, as droga, as bandat, as trafiqet, as teatri, por të gjitha këto të përmbledhura nën një emër të vetëm, Edi Rama".

në një sistem gjyqësor të pastër; nuk mund të jetë ajo në krye të atij institucioni.

Z.Basha ka paralajmëruar protesta për të bllokuar projektin e ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar, ndërsa i ka bërë thirrje Presidentit Meta që të vendosë pengojë ligjin e miratuar në Kuvend për shembjen e Teatrit. Cila do të ishte zgjidhja më e drejtë?

Miratimi i ligjit për shembjen e Teatrit Kombëtar ishte një ndër vendimet më të paskrupullta që ndërmori kjo qeveri, duke përdorur si marionetë deputetët e saj. Ishte një vendim korruptiv, diktatorial dhe i paprecedent. Të shembësh tempuj të tillë do të thotë të urresh kulturën e kombit tënd, të kesh çrregullime destruktive, të cilat të nxisin të fshish të bukurën e së kaluarës së vendit tënd, kulturën e vendit tënd. Teatri është i artistëve dhe qytetarëve, ndaj e vetmja mënyrë për një vendim të drejtë mund të ishte referendumi, siç do të ndodhte në vende të tjera demokratike. Por me këtë akt tregoi edhe një herë dëshirën e madhe që ka ky kryeministër për të rua-

jtur simbolet komuniste si Piramida, 'Bunkart', 'Shtëpia me Gjethe' etj., dhe për të shkatërruar simbolet e kulturës e së bukurës siç është teatri, i cili edhe në 50 vite diktaturë, në ato momente që kalonin brenda mureve të tij na bënte të harronim terrin që ishte jashtë.

Si do të reagojë më tej opozita lidhur me këtë çështje?

Ky ishte akti të cilin nuk do ia falin qytetarët dhe opozita krah tyre. Frika për të shpëlarë komionët me para të drogës që transporton anë e kënd botës ia ka errësuar ndërgjegjen e s'di çfarë bën, i vetmi shpëtim për shpëlarjen e tyre është lavatrica e madhe e kullave.

Në këtë betejë PD-ja është bashkë me LSI-në kundër qeverisë, por a do ketë një koalicion të bashkët PD-LSI për zgjedhje lokale?

Deri tani kemi pasur një aksion opozitar, ku pjesë ka qenë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, si një parti tjetër e opozitës. Për çdo hap të mëtejshëm, ende nuk ka një vendim.



Valentina Madani

Partia Demokratike de noncoi dje ndërtimin e kullave pranë Teatrit Kombëtar. Demokratët paralajmëruan se gjatë ditëve në vijim do të publikojnë fakte të tjera të rënda të asaj që e cilësojnë aferë korruptive dhe kriminale për Teatrin Kombëtar, që lidh kryeministrin Rama, kryebashkiakun Veliq dhe kompaninë "Fusha" me botën e krimit dhe drogës. Sipas deputetes Albana Vokshi, në më pak se 4 vjet, kompania "Fusha" ka marrë 127 tendera publikë nga Edi Rama, me një vlerë rreth 80 milionë euro. Sipas opozitës, 35 prej tyre, me vlerë 25 milionë euro, "Fusha shpk." i ka marrë vetëm brenda dy viteve nga kryebashkiaku Veliq. Ajo njoftoi dje para medias se kullat do të ndërtohen në truallin e teatrit. Sipas saj, "nëse do të ishte zbatuar ligji dhe do të kishite fituar kompania me vlerën më të ulët, buxhetit do t'i ishin kursyer miliona euro, përfshirë edhe rikonstruksionin e teatrit. Pa garë lu dha sheshi 'Skënderbej', bulevardi i Vlorës, rikonstruksioni i Ministrisë së Brendshme". Deputetja demokrate, Albana Vokshi tha se vendimi për të grabitur pronën publike është vetëm me një synim, për pastrimin e parave të krimit dhe të drogës. "Edi Rama përdor 'Fusha shpk' si kompani guaskë për të pastruar paratë e pista të drogës dhe korrupsionit tek 6 kullat, 3 prej të cilave janë parashikuar të ndërtohen në territorin e Teatrit Kombëtar. Votimi antikushitetues i parlamentit për të shembur Teatrin Kombëtar dhe për të grabitur tokën publike është një akt mafioz, nëpërmjet të cilit Edi Rama dhe kompania 'Fusha' do të ndërtojnë 6 kulla në Qendrën Historike të Tiranës, 3 prej të cilave në territorin e teatrit", theksoi zj.Vokshi. Sipas saj, "pastrimi i parave të pista të drogës dhe korrupsionit është arsyeja e vetme për nxitimin e Edi Ramës për të miratuar brenda 5 ditësh me procedurë të përshpejtuar, në shkëlqim të rregullores, të 4 ligjeve në fuqi dhe të Kushitetutës një ligj të personalizuar me emrin e kompanisë 'Fusha'. Duke përdorur 'Fusha shpk.' si kompani guaskë për pastrimin e parave të pista të drogës dhe korrupsionit, fitimi minimal për Edi Ramën nga ky akt mafioz, i paprecedentë në historinë e parlamentit shqiptar, është jo më pak se 205 mln euro". Por, Vokshi paralajmëroi se opozita dhe qytetarët që duan kulturën nuk do të lejojnë grabitjen e pronës publike. "Partia Demokratike, opozita, qytetarët që duan ruajtjen e vlerave kulturore, si pjesë e identitetit tonë europian,

Vokshi zbardh faktet: Kompania që do ndërtojë teatrin ka marrë 127 tendera publikë nga Rama

Shembja e teatrit, PD: Me 6 kullat do pastrohen paratë e drogës

"S' do të lejojmë grabitjen e pronës publike"



Deputetja e PD Albana Vokshi

PETRIT VASILI

Kreu i grupit parlamentar të Levizjes Socialiste Per Integrim Petrit Vasili, duke iu referuar çështjes së teatrit, bën një krahasim me Makbethin dhe duart që nuk lahen kurrë nga gjaku. Vasili shkruan në "Facebook" se, "në Kuvend nga 75 obskurantistë, shpirtshkur e inkuizitorë dhe jo nga të vërtetë aktorë, u luajt Makbethi qeveritar, grabitqar".



LSI: Rama po i rri stoik absurditetit

Deputeti i LSI-së, Shezai Rrokaj e cilësoi dje qëndrimin e qeverisë për Teatrin Kombëtar si absurditetin më të madh që mund të bëjnë institucionet kundër trashëgimisë së vendit. Ai shprehet se kryeministri Rama "po i rri stoik absurditetit të një fiksimi 20-vjeçar". "Absurd-teatri si pjellë e absurditetit të një fiksimi? Kryeministri e tha para disa ditësh se teatri nuk është më pjesë e historisë. Po i rri stoik absurditetit të një fiksimi 20-vjeçar. Po në Evropën ku kërkojmë të shkojmë modernizmi është në vazhdim dhe në harmoni me traditën, e cila ruhet si objekt kulturi, si pasuri e gjeneratave, si kujtesë që bashkon brezat, duke krijuar arketipin identitar në kuptimin e Jungut. theksoi deputeti i LSI-së,

Teatri, Tabaku: Qeveria ka gati kontratën, këtë verë nis shembja

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, deklaroi dje se qeveria shqiptare duket e vendosur për të shembur godinën e Teatrit Kombëtar, edhe pse artistët po protestojnë kundër këtij vendimi. Tabaku tha në emisionin "Kjo javë" në "News 24", se ligji për shembjen e teatrit është një akt korruptiv. "Ne i kemi kërkuar mazhorancës që të na vendosë në dispozicion dokumentin sesa është marrë ky vendim, por asnjë zyrtar shteti nuk na jep dot përgjigje për këtë. Salla e parlamentit ishte bosh në pjesën më të madhe të kohës, pasi askush nuk mund ta mbronte atë projektligj. Deputeti Tavo rezultoi në votim, edhe pse s' ishte në seancë. Në një parlament tjetër demokratik, ai ligj do të ishte bërë nul, por kjo gjë nuk ndodh në Shqipëri. Javën tjetër ata do të avancojnë me vendimin. Në dijeninë tonë, ata e kanë kontratën gati dhe nuk është çudi që brenda verës të fillojë puna për prishjen e Teatrit", theksoi Tabaku. Ajo komentoi dokumentin autentik të shitjes së pronës ku është godina e Teatrit, një kontratë e vitit 1938. "Kontrata e shitjes së pronës që unë prezantova në Komisionin e Ekonomisë e vitit 1938 tregon se pasardhësit e ish-kryebashkiakut të parë të Tiranës e kanë shitur atë me qëllim që të ishte pronë publike dhe teater", theksoi Tabaku.



qytetarët që duan Tiranën, qytetarët që nuk pranojnë grabitjen dhe qeverisjen nga mafia nuk do të lejojnë triumfin e së keqes. Transpar-

Ligji, Shehu: Na largon me Evropën, vepra ka kulturë italiane brenda

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu, i ftuar dje në "News 24" foli për ligjin tashmë të miratuar që i hap rrugë shembjes së Teatrit Kombëtar. Shehu edhe në fjalën e tij në Kuvend tha se ky është një ligj që na largon nga Perëndimi, pasi lejon prishjen e një veprë që ka kulturë italiane brenda. "Ai ligj përmbante në vetvete dhe disa probleme që u bënë shkak edhe për moshapjen e negociatave. Kjo tregon se qeveria ecën me kokëfortësi, në rrugë të mbrapshtë dhe të gabuar, vetëm sa na largon me BE-në, por shton edhe probleme në vend. Ai ligj kishte disa probleme, një ligj arbitrar, një ligj që ishte bërë i tillë, për të justifikuar korrupsionin. U bë për t'u fshehur prapa këtij ligji, bie ndesh me parimet e ligjeve të vendit tonë. Kjo mënyrë veprimi, mbrapa së cilës përfshihen afëra gjigante është një element tjetër që bie në kundërshtim të parimeve. Ky veprim që synon të shkatërrojë një veprë kombëtare, duke e tjetërsuar truallin për interesat të ngushta godet rëndë atë që ka ngehur nga pasuria perëndimore që ka. Po goditet në mënyrë selektive çdo objekt që lidhet me kulturën italiane. Kjo gjë u bë gjatë komunizmit, por edhe tani", deklaroi z.Shehu.



hmojë shqiptarët të marrin vendimin e tyre", theksoi deputetja e PD-së. Parlamentar miratoi në seancën e së enjtes vetëm me votat e

mazhorancës projektligjin për Teatrin Kombëtar. Ndërsa aktualisht pritet dekretimi i tij nga presidenti për të hyrë në fuqi.

MARRËVESHJA SHTYRJA

Mediat greke: Tsiptas shtyn pa afat marrëveshjen me Shqipërinë, shkak tensionet e brendshme

"Kathimerini": "Ngrin" marrëveshja me Shqipërinë deri në janar 2019

"Presidenti shqiptar heziton nënshkrimin me Athinën"

Qeveria greke ka vendosur ta shtyjë për më vonë finalizimin e marrëveshjes me Shqipërinë. Shkaku i këtij vendimi gjendet në "regimet e furishme" për marrëveshjen Athinë-Shkup mbi çështjen e emrit të Maqedonisë - shkruan e përditshmja greke "Kathimerini". Gazeta greke sjell në vëmendje hezitimin që ka presidenti shqiptar, Ilir Meta për të autorizuar nënshkrimin e marrëveshjes, teksa i njëjti kryeministrit Rama vullnetin për të ecur përpara me marrëveshjen. Ministria e Jashtme shqiptare nuk ka dhënë asnjëherë detaje mbi këtë proces, por vetëm ka njoftuar zhvillimin e tri raundeve të bisedimeve, duke nënvizuar klimën bashkëpunuese dhe pozitive të palëve. "Stuhia e reagi- meve për marrëveshjen e Prespës ka krijuar shqetësim në selinë kryeministrale, prandaj dhe mendohet shtyrja e zgjidhjes së disa problemeve (me Shqipërinë), pasi të finalizohet rruga e mundimshme e ratifikimit të marrëveshjes për emrin", shkruan "Kathimerini". Por, gazeta vë në dukje se "negociatat me Tiranën nuk kanë për t'u ndërprerë, posaçërisht ndërmjet komisioneve që po merren me anën teknike të marrëveshjes për zonat ekskluzive ekonomike". Sipas "Kathimerini", "përtej dimensionit politik të çështjes, negociatat me Shqipërinë për ZEE shpeshherë komplikohen për shkak të ekuilibrave të brishtë politikë në vendin fqinj. Aty, Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta paraqitet skeptik për miratimin e një marrëveshjeje që siç duket, kryeministri Edi Rama është shumë më i gatshëm të promovojë", thuhet në shkrimin e "Kathimerini". Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje të vlerësuar nga Brukseli ka



Do ministrit e Jashtëm i Greqisë dhe Shqipërisë

HEZITIMI

Gazeta greke sjell në vëmendje hezitimin që ka Presidenti shqiptar, Ilir Meta, për të autorizuar nënshkrimin e marrëveshjes, teksa i njëjti kryeministrit Rama vullnetin për të ecur përpara me marrëveshjen. Ministria e Jashtme shqiptare nuk ka dhënë asnjëherë detaje mbi këtë proces, por vetëm ka njoftuar zhvillimin e tri raundeve të bisedimeve, duke nënvizuar klimën bashkëpunuese dhe pozitive të palëve.

"Kjo monstër politike duhet ndalur sa më parë"

Kryemadhi publikon videon: Rama s'njeh kufij, po grabit pronat e shqiptarëve

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi publikoi një video ku shkruan se kryeministri Rama po përpiqet që të grabisë pronat e shqiptarëve. Teksa sulmon Ramën për grabitje dhe tjetërsim të pronave, Kryemadhi thekson se në këtë rast po veprohet njësoj si me Teatrin Kombëtar. Në video dëgjohen disa gra që qajnë dhe akuzojnë policinë për padrejtësi. "Skanë pikë gjynafi s'kanë, shifi sa gjynah", thotë një grua teksa qan. Kryemadhi vazhdon më tej me akuzat dhe shtron se policia është në krah të grabitësve të kësaj prone dhe kundër atyre që e kanë vlerë në bazë të ligjeve. "Video tregon qartë se si kryeministri po përçatit grabitjen dhe tjetërsimin e pronës së shqiptarëve, jo vetëm në



qendër të Tiranës, por edhe në rrethinat e saj. Makutëria e tij nuk njeh më asnjë kufi ligjor dhe moral! Në mënyrë arbitrare policia është në krah të grabitësve të pronës së familjeve shqiptare, që e kanë blerë atë në përputhje me ligjet në fuqi. Ende pa hyrë në fuqi ligji, sejmënt e Edi Ramës po u turren

rritur presionin e opozitës greke, e cila kërkuan mbledhje urgjente të Komisionit për politikën e jashtme. "Kathimerini" shkruan se vendimi i Tsiptas për të shtyrë firmosjen e

paktit me Tiranën ka për qëllim shfryrjen e tensioneve të brendshme deri në ratifikimin e plotë të marrëveshjes me Shkupin. "Në axhendën e brendshme të Shqipërisë, ku tematika sh-

pronave dhe shtëpive të shqiptarëve duke vjedhur ç'të mundin. Ngjarja flagrante e shënuar sot në Kashar është vetëm fillimi i një procesi që Edi Rama e ka projektuar dhe ka nisur ta zbatojë që nga Teatri Kombëtar e më tutje. Kjo monstër politike që nuk njeh më asnjë kufi në vjedhje dhe grabitje duhet ndalur në mënyrë urgjente! Papërgjegjshmëria dhe perversiteti i tij jo vetëm politik, prej kohësh po shkatëron jo vetëm çdo normë, ligj e moral, por tashmë po gllabëron edhe pronat e ligjëshme të shqiptarëve. Ky është momenti kur shqiptarët duhet të ngrihen dhe ndalojnë dorën e këtij satrapi, të cilin nuk e ndal dot as drejtësia e komanduar nga ai vetë", shprehet zj.Kryemadhi.

trohet gjithmonë me tone ekstreme gjendet shumë lart çështja e të quajturës 'Çamëri', që siç ka deklaruar në mënyrë të përsëritur pala greke, nuk ndodhet në tavolinën e bisedimeve",



SHKRESA PER KUVENDIN

Vetingu, KPK kërkon shtim personeli dhe rritje pagash

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kërkon shtim personeli në këtë institucion si dhe rritje pagash. Shkresa i është dërguar kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi; kreut të Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja; ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj; ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj si dhe për dijeni sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Engjëll Agaçi. Në kërkesë thuhet

KERKESA

Në kërkesë thuhet se organika ka në përbërje 12 këshilltarë juristë dhe 4 këshilltarë ekonomistë.

se organika ka në përbërje 12 këshilltarë juristë dhe 4 këshilltarë ekonomistë. Pas shpërndarjes së çështjeve në trupat gjyquese, një këshilltar ekonomik duhet të punojë njëkohësisht me 3 këshilltarë juristë për tri çështje të ndryshme, pra të mbulojë 3-fishin e punës së këtyre të fundit. Ndaj, KPK shprehet se duke parë ngarkesën e madhe dhe voluminoze në mbulimin e dosjeve të subjekteve të rivlerësimit, kohën e limituar që ka institucioni për realizimin e misionit, objektivave dhe detyrave të caktuara nga Kushtetuta, e vlerëson si tepër të rëndësishme rritjen e numrit të personelit me: 8 këshilltarë ekonomistë, duke e çuar numrinin e tyre në 12 këshilltarë ekonomistë. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e veçantë që ka përkthimi për komunikimin e akteve dhe gjithë dokumentacionit te partnerët e huaj, KPK kërkon shtesë personeli me 2 përkthyes, për të arritur në total në 5 përkthyes.

vazhdon "Kathimerini". Sipas gazetës greke, ajo që po diskutohet lidhet me pa-suritë e shtetasve shqiptarë që janë vënë në sekuestro që nga shpallja e ligjit të gjendjes së luftës, në vitin e largët 1940. "Kathimerini" vë në dukje se deri në këto momente janë bërë hapa të pjeshëm në çështje të nivelit të ulët, siç është vula apostile apo njohja e patentave shqiptare, ndërsa ndodhet në zhvillim e sipër procesi i zhvarrimit dhe identifikimit të ushtarëve grekë

që ranë në luftën italo-greke. Gazeta u referohet citimeve të herëpashërshme nga burimet diplomatike greke, sipas të cilave, "është shënuar progres në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e minoritetit etnik grek në Epirin e Veriut". Nga ana tjetër, ende mbetet pezull çështja e ligjit të gjendjes së luftës, sa nga pala greke edhe ajo shqiptare, për shkak të disa vështirësive juridike, përfundon "Kathimerini".

Ndryshon ligji për tatimin mbi fitim, përjashtohen tokat bujqësore

Ornela Manjani

Personat që shesin tokë bujqësore, të cilën e kanë përfiturar me ligjin 7501 do të përjashtohen nga tatimi mbi fitimin. I vetmi kusht për të përfiturar përjashtimin nga 15% e tatimit është fakti se kjo tokë duhet të mbetet bujqësore dhe jo të përdoret për truall. Po ashtu, taksa e tatimit fitimit nuk do të paguhet as në momentin që bëhet kalimi i pasurisë brenda brezit të parë burrë, grua, fëmijë në momentin që toka është fituar me ligjin 7501. Diskutimi nen për nen i paketës fiskale solli një tjetër lehtësi për sektorin e agroturizmit, përveç prodhimeve të saj, të cilat do të kenë një TVSH të reduktuar 6%. Ferma që do të ketë edhe struktura akomoduese do të përfitojë Tatim mbi Vlerën e Shtuar po 6% edhe për mallrat që merr furnizim. Kërkesa për të ndryshuar këtë nen erdhi nga mazhoranca.

TAPIA

Të gjitha familjet bujqësore që kanë marrë tokë në vitin 1991 me ligjin 7510 do të marrin tapitë. Personat që zotërojnë titujt e pronësisë dhe Aktet e Marrjes së Tokës në Përdorim, të fituara me ligjin për tokën bujqësore do të verifikohen nga komisionet vendore pranë njësive të qeverisjes vendore. Komisionet vendore do të verifikojnë nëse sipërfaqja e tokës, e dhënë në korrik të vitit 1991 është në përputhje me gjendjen familjare në atë moment dhe nëse dokumenti është lëshuar sipas rregullave dmth., nëse janë të rregullta firmat dhe vula. Më pas titujt e rregullt do të regjistrohen në hipotekë. Titujt e pronësisë ose aktet e përdorimit, të dhëna me ligjin 7501, sipas të cilit është ndarë toka bujqësore në korrik të vitit 1991 verifikohen nga komisionet vendore. Akti i marrjes së tokës në pronësi, ose akti i marrjes së tokës në përdorim për rastet kur nuk është marrë tapia do të verifikohet, pasi mund të mungojnë firma ose vula në këto dokumente. Komisionet vendore do të shqyrtojnë rastet jo vetëm

Shitja e tokës së marrë me '7501'-shin nuk do të tatóhet

Edhe dhurimi i arës nuk tatóhet me 15%



të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me e-mail, dërgimit të përgjigjes elektronike tek "Dokumentet e mia" në portalin e qytetarit në "e-Albania", si dhe me shërbim postar, nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRRP), në zbatim të Ligjit Nr. 33/2012 bëhet nga kërkuesi, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noteri apo asistenti i noterit. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme funksionon Regjistri Elektronik i përpunimit të kërkesave, i cili garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave. Minimalisht, në regjistrim regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik. Kërkuesi, që paraqet një kërkesë për kryerjen e një shërbimi nga ZRRP-ja, pajiset me një numër identifikimi të kërkesës dhe Kodin e Sigurisë, me anë të të cilëve mund të verifikojë gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij. Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit tek "Dokumentet e mia" në "e-Albania" dhe informimit me e-mail për shkarkimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Cdo tarifë për shërbimin në ZRRP paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit.

Verifikimi i tapive

Të gjithë titujt e pronësisë që janë përfiturar në zbatim të ligjit për ndarjen e tokës bujqësore do të verifikohen jo vetëm për ligjshmërinë e lëshimit të tyre, por edhe me ballafaqimin e sipërfaqeve në terren me ato të regjistruara në dokumentet. Në ligjin 7501 është përcaktuar që toka bujqësore të ndahet për frymë për banorët që janë regjistruar në fshat në momentin e ndarjes së tokës, në korrik të vitit 1991. Të dhënat e sakta do të hidhen në regjistrin e Zyrave të Regjistrimit të Pasurive. Në ZRRP do të regjistrohen edhe të gjitha vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë. Në përfundim të këtij procesi të gjitha sipërfaqet që do të rezultojnë të lira, do të kalojnë në fondin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave.

për vlefshmërinë ligjore të aktit, por edhe normën e sipërfaqes për frymë që ka përfiturar familja bujqësore në momentin që është ndarë toka. Do të verifikohet nëse sipërfaqja e përfiturar është konform ligjit 7501 dhe a është në përputhje me sipërfaqen e përfiturar gjendja familjare në momentin e përfitimit të tokës bujqësore. Të gjitha familjet që kanë përfiturar tokë me ligjin 7501 dhe kanë Aktin e Marrjes së Tokës në Përdorim duhet të bëjnë kërkesë pranë njësive të qeverisjes vendore për të marrë titullin e pronësisë, tapinë. Njësia e qeverisjes vendore bën verifikimin dhe më pas dosja kalon në Zyrat

e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bëhet vetëm regjistrimi.
REGJISTRIMI
Regjistrimi i pronave në zonat rurale do të kryhet përmes portallit "e-Albania" dhe ka një kosto prej 30 mijë lekësh. Në të njëjtën portal mund të aplikojnë për certifikatën e pronësisë edhe personat që kanë marrë toka bujqësore me ligjin 7501, por duhet të dërgojnë nëntë dokumente. Shërbimi elektronik për regjistrimin e pronave në zonat rurale u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për regjistrim fillestar të veçantë të pasurive të paluajtshme në zonat rurale përpara kohë zona nuk është përfshirë në këtë proces. Pas dërgimit të aplikimit drejt Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ai do të procesohet nga specialisti i ZRRP-së dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve

MINISTRIA



Siguria ushqimore, në fokus, produktet e gatshme

Ministria e Bujqësisë do të ushtrrojë kontrolle të shtuara gjatë sezonit voral tek subjektet që forcojnë produkte të gatshme, por edhe tek inputet bujqësore, për të garantuar sigurinë ushqimore të konsumatorëve. Zvministria e Bujqësisë, Ermira Gjeçi, bën me dije se është trefishuar sasia e produkteve të bllokua apo të asgjësuar. "Është rritur numri i kontrolleve dhe inspekteve gjatë sezonit të verës dhe kjo për dy arsye madhore. E para është rritja e numrit të popullatës në zonat turistike dhe e dyta është për hir të temperaturave të larta, të cilat shoqërojnë sezonin. Nuk është i rëndësishëm vetëm kontrolli dhe analizi i produkteve të gatshme, por edhe ajo e inputeve bujqësore. Inputet bujqësore kanë një rol tepër të rëndësishëm në produktin e gatshëm, në frutat dhe perimet. Tetor 2017-qershor 2018 me periudhën e vitit paraardhës, bllokimi dhe asgjësimi i produkteve është në masë të rritur rreth trefish, 25.3% ka qenë në periudhën paraardhëse dhe ka vajtur në 75.4%", u shpreh Gjeçi. Sipas të dhënave zyrtare të bujqësisë, është trefishuar edhe numri i gjobave të vendosura ndaj subjekteve gjatë periudhës tetor 2017-qershor 2018, ndërsa vlera e tyre është regjistruar në 6.8 milionë lekë. Po ashtu, janë bllokuar dhe asgjësuar 50 tonë në shumë produkte se 9-mujori i një viti më parë.

Unaza e Fierit, Gjijnuri: Të dielën përfundon segmenti Rr.Patosit - QTU Fier



Ministri Gjijnuri tha se ky segment do të jetë i hapur për qarkullimin e mjeteve brenda ditës së diel të kësaj jave. "Para dy javësh ne ishim këtu

për të shënuar fillimin e punimeve për ndërhyrjen në këtë aks shumë të rëndësishëm, por të lënë pas dore për shumë vite. Siç e shikoni, ky segment i Unazës tanimë po transformohet plotësisht, duke marrë pamjen e një rruge me standardet e duhura. Brenda 24 orësh do të përmbyllet puna për shtimin e shtresave asfaltike dhe do të hapet qarkullimi për metjet", u shpreh Gjijnuri. Nderkaq, po vazhdon

puna rehabilituese në segmentin tjetër të Unazës së Fierit, nga rreth-rrotullimi i Sheqit deri tek rreth-rrotullimi i Patosit. Po punohet me intensitet, ndërsa parashikohet që brenda një jave edhe ky segment i dytë i Unazës së Fierit të ketë përfunduar dhe të jetë i hapur plotësisht për qarkullimin e mjeteve. Ministri Gjijnuri theksoi se Autoriteti Rrugor Shqiptar ka në zbatim tanimë një plan ndërhyrjeje për rehabiliti-

min e shumë akteve rrugore të konsideruara si problematike në gjithë vendin. Sipas tij, fillimisht është ndërhyrë në aksin që janë konsideruar në gjendje më emergjente, ndërsa pjesa tjetër e ndërhyrjes do të kryhet gjatë muajit shtator. Ndërhyrja rehabilituese në Unazën e Fierit po kryhet në kuadër të projektit të përbashkët me Bankën Botërore për mirëmbajtjen me performancë të akteve rrugore.

Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Damian Gjijnuri bashkë me drejtorin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Afrim Qendro inspektuan punimet që po kryhen për rehabilitimin e dy segmenteve të Unazës së Fierit, të konsideruara si problematike për qarkullimin e mjeteve. Në segmentin nga Rreth-rrotullimi i Patosit deri në zonën pranë ish-QTU Fier, pas punimeve të nënshtrësive dhe riparimit të sistemeve të kanalizimeve, është në fazën përfundimtare edhe ndërhyrja për shtimin e asfaltit.


Aplikuan për certifikatë pronësie në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Ornela Manjani

Hipoteka publikon listën me 300 persona na që kanë përfituar lejet e legalizimeve dhe që duhet t'i drejtohen Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë për të aplikuar për certifikatë pronësie. Përfituesit janë në Tiranë. Lista është botuar në faqen zyrtare të ALUIZNI-t dhe u bëhet me dije qytetarëve që gjejnë emrin në të dhe të shkojnë të aplikojnë për certifikatë pronësie në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarrimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë, sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipër-

Hipoteka, ja 300 personat që kanë gati tapitë e shtëpive

Përfituesit në të gjitha njësitë e kryeqytetit



faqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më



shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak

të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim,

i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të mirat-

uar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më pak vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përpulthet vullneti.

LISTA ME PERFITUESIT

EMER JONUZ	MBIEMER POKO	FATMIR GEZIM,FATMIR	XHONGOLLI BELBA	BAJRAMI CANE	GJON ATLUM	MALETAJ NGOTA	EDMOND PANDELI	HAXHINASTO MONE	YMER LLANAJ	AS
ASTRIT BUKURIE,BLENDI,GENTIANA ZELA, HYKA, KRUTANI SELIM BALLA	ADEMAJ PEPOSHI MALE	BARDHOK ELTON DRITAN ARBEN ALFRED ESAT AVDIL PAL ZEF MUHARREM	KALECI NDRECPECAJ SULKO UKA SINA PACI NDOCI LEKAJ TOPALLAJ XHETAN SELAMI BEQIRI SORRA NAIM MANREKA LLESHI HASANILLARI NAZIR BAJRAM DRITAN ZHILLIMA MUSABELLIU	DIANA SHABAN DOCI DODA BRUNILD,ANILA GARUNJA,DERMANI MERKUR GJOSHI NOVRUZ GODUNI OSMAN,SAMI HASTOCI FIDAI,KUJTIM,ARQILE MADHI YLLI MENAJ HAXHIRE SORRA RIFAT ZAIMI DYLBER SHABANI ILIR DEMARKU ISMET HAYA XHELADIN ALI NELLI CERMA ENVER BAKALLI GJON,MIRASH LOGU XHAVIT KOCI DASHAMIR TOPALLI NAZIF SHABANI MAKBULE DISHA MACAJ KODRA SULA ZENUNI IBRAHIM SHELQIZI HALIT MEMA BRAHOLLI ZENEL KACELI AVDI SHALCA RUZHDI STOLI ADRIAN,SAMIR KAL-LUSHI KOKONOZI BESNIK ABESHI DERVISHI KOKONOZI MARGARITI ALMA LUAN AGA RAHMANI KOSTA MUSTAFIRA ALMADHI HISA LULO ENGJELL	DAPI DEDNDREAJ DOCI DODA VATHI DACI NAZIM,KOLLICINAKU ALBAN BEKA GJOVALIN FRROKU MARTIN TOTAJ SULEJMAN BALLIU DILAVER BASTRI BYCI IBRAHIMLLARI EUGEN,SELAMI KODRA DEMIR KRUSA BEQIR LIKA JEMIN LIMANI SABRI LLUKAJ AJDIN SMACI ASRIT BAKALLI DILAVER ASLLANAJ NIMET QEMALI PUJETER AHMETAJ QAZIM XHAVIT SKENDER BUJAR NEZIRI ZEFIRE,KLODIAN TAHIRI BEDRI VEIZI GJERGJ KOLIQUI GAZMIR,SHQIPE NGOTA DYLBERE SULA NDOKE KOLENDREU RAMADAN RAMA MUHAREM LASKU SULEJMAN KOLECI ZENEL LAMA RESHIT XHANI SHABAN SHIQERUKAJ LAZIM KRUSA ENGJELLUSHE KURTI EDMOND SULA ARTUR CAMI LIRI BEKA TARJA QEMAL DALLIU EDUART TRIMI SEFEDIN, FERDINANT AGALLIU BASHA AZBI	MOCKA SHABANAJ XHYHERI HAXHIAJ LUSHA BARDHI LALA TAMJA MYFTARAJ SKENDERAJ AGOLLI ALEKSANDRA NASKA JETA,ARJANA,FLUTURE,EDUARD DERVISHAJ XHAVIT BILALI KASTRIOT,THELLEZAR,ROLAND HILA MECANI YLLSON ENVER VODOLLARI MOISI RAMA KAMBER BEJO ASLLAN XHAFI ADEM, RENATO XHEPA MIHAL TRIMI SHKELQIM XHEPA PETKU SHABA RAMA HAKRAMA GRRICA XHAMETA BICAKU HOXHA AVDIL HOXHA NDOINI NDREKO SABIRE SHKURTI ADRIAN PROKO FADIL AVDIA FLAMUR, RUMALF DERSH VISHI MELANI PASHAJ AUROK PASHAJ GJOK NDOU RAMAZAN,GJYZE HALILI DASHURIGENTIANE,LSBERKENA KUCUKU YLLI KURTI ISUF BARDHYL MERDINI NJAZI BELULI ABDYL,VULLNET KURTI BINAS MATA DUKAGJIN QERIMI	LLALLAH DAFKU ILMI DIDA GJOVALIN MARTI-CANAJ ESAT CIBAKU PRANVERAKUCI IBRAHIM BODINI NAIM LIKA FATMIR MEHMETI SADIK,FATOS LOKA SHKELQIM PASHA QERIM THACI MOJSI ZUNA LUTFI DURISHTI LUSH MARASHI KOSTA KARAMUCA ASDREN BALI ISUF HASA AHMET NDREKA HASAN DIDA LAVDERIM HOXHA AGRON PRENCI ARBEN TEROLLI FEHMI KACA ISMET LIKA MUSTAFA LOCA MEHMET PERGJEGJII DASHAMIRGOZHARI DASHAMIR BODINI ALBERT CAPI EDUARD BOKA SHKELQIMSULAJ ANFERLATS-PRESADRIAPET VLADI LLESH, ALFONSSULEJMANI, GJOKA RIZA HASA VATH CEKA MIRBAN KADIU MENTOR SKENDERI MUHARREM CAUSHI BRIJA HAKA BUSHAR BESHIRI LIRIE DOMI KUJTIM BALLIU RESHAT RRABI BRUCI ZABIT GJABRI SELVI LAMI RAZIM SHULI			

“Malli ishte përzier me qymyr. Mjeti lundrues ‘Sea Scanner’ është nisur drejt Kroacisë

Anija me flamur të Sierra Leones “arratiset” me 500 tonë kripë nga porti i Durrësit

Kreu i Kapitenerisë: Shkak, konflikti tregtar mes kompanisë pritëse të mallit dhe asaj transportuese

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Një anije tregtare me 500 tonë kripë është arratisur nga porti i Durrësit mëngjesin e djeshëm pa marrë leje nga autoritetet portuale. Mësohet se anija tregtare “Sea Scanner” ishte nisur nga Egjipti dhe kishte sjellë afro dy javë më parë 6 mijë tonë kripë për llogari të një biznesi në Durrës. Por, pasi u shkarkua sasia prej 5500 tonë kripë, pati mosmarrëveshje midis subjektit pritës dhe transportuesit. Biznesmeni shqiptar pretendoi se sasia prej 500 tonë kripë është dëmtuar, ndaj nuk u bë shkarkimi i mallit. Pas konfliktit midis palëve, anija doli nga kalata ku shkarkoi mallin në radën e jashtme të portit. Pas disa ditë qëndrimi dhe moszgjdhjes se konfliktit civil midis biznesmenit shqiptar dhe kompanisë transportuese, dje anija u largua nga porti. Ndërkaq, burime nga Kapiteneria e Portit të Durrësit bënë me dije se është policia Kufitare dhe Roja Bregdetare që merren me sigurinë e portit dhe të lëvizjes së mjeteve lundruese, për sa kohë sa anija gjendet në radë, jashtë kalatave portuale. “Policia Kufitare duhet ta kishte mbajtur nën mbikëqyrje, nuk është përgjegjësi e Kapitenerisë. Anija nuk ishte as e bllokuar, por kishte konflikt biznesi”, tha kapiteni i portit. Nga ana tjetër, policia Kufitare nuk ka dhënë asnjë reagim.


REAGIMI I KREUT TË KAPITENERISË
Taulant Allka kreu i Kapitenerisë së Durrësit në një prononim për “Gazeta Shqiptare” pohoi se largimi i anijes “Sea Scanner” nga porti i Durrësit është përgjegjësi direkte e kapitenit të saj. Allka sqaroi se konflikti tregtar midis kompanisë pritëse të mallit dhe asaj transportuese nuk gjeti zgjidhje për shkak se sigurancioni nuk mbulonte dëmin e shkaktuar të 500 tonëve kripë. Madje, Allka ka vënë në dispozicion të “GSH” dhe dokumentacionin e hyrjes, qëndrimit dhe daljes së anijes me flamur të Sierra Leones e nisur nga Egjipti me 6 mijë tonë kripë. Sipas Kapite-



Taulant Allka, kreu i Kapitenerisë së Durrësit

nerisë Durrës, anija në fjalë më herët kishte transportuar qymyr dhe hambari i saj nuk ishte pastruar, çka bëri që kompania tregtare shqiptare të mos marrë sasinë prej 500 tonë kripë për shkak se ishte përzier dhe ndotur. Taulant Allka përjashtoi mundësinë e trafikimit të qenieve njerëzore apo refugjatëve sirianë me këtë anije që sipas tij nuk ishte kontrolluar nga autoritetet, por shkak

ishte konflikti tregtar që bëri të largohej pa leje. Në bazë të dokumentacionit që disponon “GSH”, rezultoi se ekipazhi i përbërë nga 13 marinarë ishte me shtetësi egjiptiane, ndërsa kapiteni i anijes me shtetësi siriane. Mësohet se anija “Sea Scanner” është drejtuar portit të Rijekës në Kroaci, aty ku pritet që kapiteni i anijes të përballlet me masat ndëshkuese për shkeljen e ligjeve ndërkombëtare të lundrimit.



Faksimile e dokumentit për Autoritetin Portual

KAPITENI SIRIAN

Prej vitit 1997 nuk kishte ndodhur që një mjet lundrues të largohej nga porti pa marrë lejen e autoriteteve portuale. Në bazë të dokumentacionit që disponon “GSH”, rezultoi se ekipazhi i përbërë nga 13 marinarë ishte me shtetësi egjiptiane, ndërsa kapiteni i anijes me shtetësi siriane. Mësohet se anija “Sea Scanner” është drejtuar portit të Rijekës në Kroaci, aty ku pritet që kapiteni i anijes të përballlet me masat ndëshkuese për shkeljen e ligjeve ndërkombëtare të lundrimit.

KONFLIKTI

Anija me flamur të Sierra Leones hyri në portin e Durrësit më 23 qershor. Para përfundimit të shkarkimit, kompania shqiptare kërkoi ndërprerjen e operacionit dhe pjesëmarrjen e shoqërisë së sigurimeve, e cila deri më sot nuk është paraqitur. Konflikti bëri që anija të dërgohej në radën e jashtme të portit më 2 korrik, ndërsa dje u arratis me ngarkesën prej 500 tonë kripë.

Operacioni “Forca e ligjit”, bllokohen edhe 12 llogari bankare

U dënua me 9.4 vite burg për trafik të personave në SHBA, sekuestrohet pasuria e 49-vjeçarit

FIER – Në kuadër të operacionit “Forca e ligjit”, policia e Fierit ka sekuestruar dhe pasuri të paluajtshme, llogari bankare dhe automjete në pronësi të një 49-vjeçari. Bëhet fjalë për shtetasin Fatos Fasko nga fshati Radostin, i akuzuar për veprat penale “Organizatë kriminale” dhe “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” dhe i dënua me 9 vite e 4 muaj burg në vitin 2015 si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, që dërgonte njerëz në SHBA. Burime nga policia lokale bënë me dije se në vijim të punës kundër krimit të organizuar si dhe sekuestrimit të pasurisë që rrjedh nga veprimtaria kriminale, është hapur procedimi penal i regjistruar për veprat penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale, ose veprim-



Komisariatit i policisë Fier

tarisë kriminale” për hetime të pasurisë së shtetasit Fatos Fasko. “Si rezultat i veprimeve të kryera nga ana e sektorit për hetimin e krimit ekonomik e financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, u zbatua vendimi i datës 03.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Fier për sekuestron e pronës së Fatos Faskos”, thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, mësohet se janë vënë nën sekuestron pasuritë: apartament me sipërfaqe 127.68 m² në Tiranë, apartament me sipërfaqe 50 m² në Fier, truall me sipërfaqe 380 m² dhe 50 m² në ndërtime dhe pronë me proces legalizimi

VENDIMI

Pronat e 49-vjeçarit Fatos Fasko, i dënua për kontrabandim të personave nga Shqipëria në drejtim të SHBA-ve dhe Kanadasë u sekuestruan nga Policia e Shtetit me vendim të Gjykatës së Fierit dhe në kuadër të operacionit “Forca e Ligjit”.

me sipërfaqe 548.3 m² në fshatin Radostin, Fier. Gjithashtu janë sekuestruar dhe dymbëdhjetë llogari bankare në emër të shtetasit Fatos Fasko dhe të familjarëve të tij me gjendje 1.300.000 lekë e tre automjete. Ndërsa vijon puna për identifikimin e pasurive të tjera që mund të ketë 49-vjeçari.



Shembet ish-uzina ku mblidhnin skrap, vdes 27-vjeçari, rëndë shoku i tij

KURBIN - Një 27-vjeçar ka humbur jetën, ndërsa shoku i tij është plagosur rëndë, pasi kanë përfunduar nën rrënoja tekta mblidhnin skrap në ish-uzinën e superfosfatit në Laç. Mësohet se dy të rinjtë: Drilon Lamaj, 27 vjeç dhe Dashamir Hajha, 22 vjeç po tentonin të merrnin skrap, kur muret dhe soleta e uzinës u shembën duke i zënë poshtë. Kanë qenë banorët të zonës, të cilët kanë njoftuar menjëherë autoambulancën dhe policinë. Menjëherë, 27-vjeçari është dërguar në Spitalin e Traumës në Tiranë, por me gjithë ndihmën e dhënë nga mjekët, ai nuk ka mundur t'u mbijetojë plagëve. Ndërsa, 22-vjeçari Hajha ndodhet në spital në gjendje kritike për jetën. Ndërkaq, policia po heton për zbardhjen e rrethanave të kësaj ngjarjeje.

TIRANË. Pesë vite pas arratisjes së bujshme nga qelitë e burgut të sigurisë së lartë në Drenovë, Interpol Tirana ka ekstraduar nga Greqia 33-vjeçarin Eduart Lulo, i dënuar me 20 vjet burg. I riu nga Përmeti ishte shpallur në kërkim ndërkomëtar pas arratisë nga burgu më 23 nëntor të



I arrestuari Eduart Lulo

U arratis nga burgu i Drenovës me Admir Tafilin,

Ekstradohet nga Greqia i dënuari me 20 vjet heqje lirie, Eduart Lulo

vitit 2013, së bashku me Admir Tafilin dhe disa të burgosur të tjerë. Mësohet se Lulo u arrestua në Athinë disa ditë pas arratisjes, më 29 nëntor. Po ditën e djeshme, u krye edhe ekstradimi i 41-

vjeçarit Franci Halili nga Saranda, i cili u arrestua në Athinë. Ky shtetas, është shpallur në kërkim, bazuar në vendimin penal të datës 15.09.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila e ka

dënuar me 7 vite burg për veprën penale: "Prodhim dhe shitje narkotikësh". Halili në bashkëpunim me një shtetas tjetër, në qytetin e Sarandës u shisnin heroinë personave të ndryshëm.

SHKURT

Shpërndanin heroinë në

Vlorë, kapen 3 flierakët

VLORË. Policia e Vlorës ka vënë në pranga tre persona nga Fieri, të cilët akuzohen se shpërndanin heroinë në qytetin bregdetar. Sipas burimeve policore, gjatë operacionit të koduar "Circle" u arrestuan shtetasit: Jetnor Xhelaj, 48 vjeç, lindur dhe banues në Visokë-Fier, Arjan Mejdan, 44 vjeç, lindur dhe banues në Ballsh-Fier, (iu sekuestruan në banesë 17 doza kanabis) dhe Reni Hasanaj, 31 vjeç, lindur dhe banues në Ballsh-Fier. Mësohet se këta persona e ushtronin aktivitetin e tyre kriminal të shpërndarjes së heroinës kryesisht pranë poliklinikës në lagjen "Hajro Çakëri" Vlorë. Në momentin e kapjes nga blutë, shtetasve të mësipërm u janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 420 doza heroinë, 2000 dollarë të falsifikuar, 25 tableta metadon, 1 peshore elektronike si dhe mjeti tip "Audi", me të cilin qarkullonin.

Ariu sulmon e plagos rëndë 36-vjeçarin

KUKËS. Një ngjarje e pazakontë dhe e frikshme ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në Kukës. Një ari ka dalë në mes të rrugës dhe ka sulmuar një 36-vjeçar. Mësohet se Shehap Dafku nga fshati Breki ishte duke shkruar për në punë (është punëtor i hidrocentralit), kur rreth orës 06:00 ka ndeshur ariun, i cili i ka dalë në rrugë, rreth 100 m afër segmentit Kukës-Shishtavec. Nga sulmi, 36-vjeçari ka pësuar dëmtime në trup dhe në njërin sy. Aktualisht ai ndodhet i shtruar në spitalin e Kukësit jashtë rrezikut për jetën. Të shqetësuar nga rasti i ndodhur, banorët e zonës kërkojnë marrjen e masave, pasi arinjtë po bëhen rrezik për jetën e tyre dhe të fëmijëve.

Trafikantët e maskuar si turistë u pikasën nga Guardia di Finanza

Trafiku i drogës nga Shqipëria në Itali, sekuestrohet 1 ton marijuanë

Arrestohen 3 skafistë, 2 prej tyre nga Vlora

ITALI

Një sasi prej 1 ton marijuanë dhe me vlerë 10 milionë euro është sekuestruar dhe nga policia italiane në brigjet e Salentos, ndërsa kanë përfunduar në pranga tre skafistë, dy prej të cilëve nga Vlora. Këtë herë trafikantët e kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në mes të ditës, duke u përpjekur të ngatërrohen mes vendasve dhe turistëve që në këtë periudhë janë me shumicë në bregdetin e Salentos. Por, efektive të Guardia di Finanza nuk iu ka shpëtuar një motoskaf i fuqishëm që lëvizte shumë ngadalë drejt brigjeve italiane. Policia kishte dyshime, pasi skafi ishte i zhytur shumë poshtë, ndaj u kanë bërë shenjë dhe iu kanë kërkuar skafistëve që të ndalojnë, por këta të fundit në kundërpërgjigje, kanë shtuar shpejtësinë për t'i shpëtuar kontrollit. Mësohet se imbarkimi është kapur nga mjetet aeronavale në gjirin e Santa Maria di Leuca. Ndërkaq, Guardia di Finanza arriti pas një ndjekjeje të shkurtër me shpejtësi të lartë, të hipte në motoskaf dhe ta bllokonte atë. Në skaf, ushtarakët gjetën dhe sekuestruan 49 pako me marijuanë në kabinë. Lënda narkotike ishte e futur në pako me madhësi të ndryshme, me një peshë totale rreth një ton, që në treg do të kishte sjellë rreth dhjetë milionë euro fitim. Mjeti i përdorur për transportin e drogës, një skaf i shpejtë, 10 metra i gjatë u konfiskua.

10

MLN EURO

Në skaf, ushtarakët gjetën dhe sekuestruan 49 pako me marijuanë në kabinë. Lënda narkotike ishte e futur në pako me madhësi të ndryshme, me një peshë totale rreth një ton, që në treg do të kishte sjellë rreth dhjetë milionë euro fitim. Mjeti i përdorur për transportin e drogës, një skaf i shpejtë, 10 metra i gjatë u konfiskua.



shqiptare, dhe se për ardhjen e skafit drejt brigjeve të Salentos, ka qenë sinjalizimi i policisë shqiptare që ka bërë të mundur zhvillimin e operacionit. Ndërkaq, burime nga policia e Vlorës pohuan se droga është nisur nga Qeparo rreth 3 ditë më parë.

REAGIMI I BERISHËS

Pas sekuestrimit të sasisë së madhe të drogës në Itali ka reaguar ish-kryeministri Sali Berisha. Në një status në "Facebook", ai shkruan ndër të tjera se, në ceremoninë e nisjes së drogës ka marrë pjesë vetë "Forca e Krimit" dhe Xhafaj. "Narkoqeveria Rama, eksportues i parë i krimin në Europë! Autoritetet Italiane kapin një ton drogë të freskët të nisur nga Vlora! Në ceremoninë e nisjes merrte pjesë "Forca e Krimit" dhe vetë Xhafaj i drogës!"-shkruan Berisha.

me dije se operacioni "The-mix 2018" u zhvillua në bashkëpunim me policinë

Shpëtohen peshkarexha në Karaburun e veliera amerikane

Mbyten dy persona në plazhet e Durrësit, humb jetën dhe turistja polake në Sarandë

Tre persona u mbyten në plazhe ditën e djeshme. Viktima e parë u shënua në plazhin e Currilave në Durrës. Burime nga policia lokale bënë me dije se rreth orës 08:20 u gjet i pa jetë pranë një hoteli në bregun e detit (në ujë). Bëhet fjalë për shtetasin A.K., banues në këtë qytet. Mësohet se grupi hetimor po punon për përcaktimin e shkakut të vdekjes (vdekje natyrale apo mbytje). Rreth orës 11:45, në lagjen nr.15 të Durrësit

(Porto Romano) është mbytur teksa ishte duke u larë në det 62-vjeçari M. M. 62 vjeç. Viktima e tretë u shënua në Sarandë. Një turistje polake është mbytur teksa ishte me pushime në këtë qytet. Sipas bluve, 52-vjeçarja Noworycka Peter Iwona ka humbur jetën teksa notonte tek një plazh në vendin e quajtur "Kanali i Çukës". Ndërkaq, Roja Bregdetare e Forcës Detare shqiptare ka bërë të mundur shpëtimin e një peshkarexhe pranë Karaburunit, e cila ndodhej në rrezik. Peshkar-

exha "Aurora 1" kishte pësuar defekt dhe kërkoi ndihmë. Në sajë të ndërhyrjes së Rojës Bregdetare, u shpëtuan dy pjesëtarët e ekipazhit të peshkarexhës, dhe një fëmijë që ndodhej bashkë me ta. Pas marrjes së sinjalit, anija e Forcës Detare rimorkioi peshkarexhën në portin e saj të daljes në Triport. Në këtë operacion ndihmoi edhe një mjet i Policisë Kufitare dhe Migracionit. Ndërsa, në Sarandë u shpëtua nga mbytja veliera amerikane "Nordic Berry", e



cila ishte duke lëvizur brenda gjirit të Sarandës, ndërsa në bord kishte 5 persona. Sipas policisë, velierës i është mbaruar karburanti në vendin e quajtur 'Kanali i Cukës'.

Pas sinjalit për ndihmë, një skaf i policisë kufitare ka shkruar pranë anijes dhe e ka rimorkiuar drejt portit duke shpëtuar jetën e turistëve.



EXTERNAL VACANCY NOTICE

ALB/TIR/18/GS/01

Office of the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) in Tirana, Albania is looking for qualified and highly motivated candidates interested to apply for the following position:

Title of Position: Snr. Programme Assistant, G5
Duty Station: Tirana, Albania
Type of contract: Temporary Assignment GS5 (General Service)
Duration: 5 months
Application Deadline: July 23rd, 2018, 17:30 CET

1. ORGANIZATIONAL CONTEXT. Define the role of the position within the team, describing its leadership role, if any, its external/internal work relationships or contacts, the contextual environment in which it operates and the scope of supervision received, and where applicable, exercised by the incumbent.

The incumbent normally receives guidance from more senior programme staff in the operation. S/he may receive indirect guidance from other sections and units relevant to the country programme(s). UNHCR Manual, Operations Plans, UN and UNHCR financial/budgetary rules and regulations will guide the work of the Senior Programme Assistant.

The incumbent is expected to have contacts within the organization and outside the duty station, as well as with partners and other stakeholders to collect information, monitor programme activities and implement administrative requirements.

2. FUNCTIONAL STATEMENT. Describe the accountabilities, responsibilities and authorities associated with the position.

Accountability (key results that will be achieved)

UNHCR country office has sufficient administrative assistance and support in routine services and activities within Programme Section thus better able to meet the needs of persons of concern.

- IP agreements are established in a timely manner, regularly monitored and reported on in compliance with established guidelines and procedures.

Responsibility (process and functions undertaken to achieve results)

- Collects, registers and maintains information on project activities.
- Prepare status and progress reports, prepare tables and draft routine correspondence.
- Prepare background material for use in discussions and briefing sessions.
- Undertake proper collection, monitoring and use of baselines, standards and indicators needed to measure and analyse programme performance, trends and target interventions.
- Review the implementation and performance of IPs agreements through appropriate physical monitoring to evaluate the projects by reviewing work plans, progress reports, budget, financial reports and expenditures. This may include field visits for specific monitoring and evaluation issues.
- Apply UNHCR's corporate tools (e.g. Global Focus, Focus Client) to assess the technical soundness of the operation and generate data for evidence-based decisions at the country-level.
- Assist in ensuring compliance in issuance of audit certificates for Implementing Partners.
- Perform other duties as required.

Authority (decisions made in executing responsibilities and to achieve results)

- Provide inputs for the country operations plan (including budgets, staffing levels and structures) as well as prepare inputs for funding submissions, appeals and reports.
- Access the relevant information and programme records, Focus/MSRP data.
- Represent UNHCR in physical monitoring of projects.

3. REQUIRED COMPETENCIES, which illustrate behaviours that are essential to achieving deliverables described above, and that are critical to successful performance. All jobs require the staff to abide to the Values and Core competencies of UNHCR. Where applicable, select a maximum of six Managerial and list up to six functional competencies. Select a maximum of three Cross-Functional Competencies. (Note that the Performance Appraisal and Management System (PAMS) allows for up to five Cross-Functional Competencies to be selected by the staff member and the supervisor.

- Managing resources
- Analytical Thinking
- Planning and Organizing

4. ESSENTIAL MINIMUM QUALIFICATIONS AND PROFESSIONAL EXPERIENCE REQUIRED.

- Completion of Secondary education courses/ training/ certificate in Business Administration, Social Science, International Law or related field.
- Minimum 4 years of previous job experience relevant to the function.
- Computer skills (in MS office).
- Fluency in English and working knowledge of another relevant UN language or local language (as applicable in the duty station).

5. DESIRABLE QUALIFICATIONS & COMPETENCIES. Describe any experience or knowledge that would be an asset, such as: UNHCR Learning Programmes, other training, additional languages, Field/HQs experience, etc.

- Good knowledge of financial rules, procedures and processes.
- Knowledge of specific program management including budgeting
- Prior exposure to UNHCR refugee operations and functions relating to office administration and programme activities.

IMPORTANT NOTE:

- Interested candidates should read the Terms of Reference carefully and apply if suitably qualified.
- Candidates are required to submit signed Motivation Letter and UNHCR P11 form.
- UNHCR P11 form and Supplement form are available: www.unhcr.org/recruit/p11new.doc (open Hyperlink). Please note that any previous versions of the P11 will no longer be considered.
- Applications of father, mother, son, daughter, or siblings of a staff member of UNHCR cannot be considered.
- Applications will not be acknowledged. Only shortlisted candidates will be contacted and invited for the written test and the interview;
- Applicants with working experience in International Organizations, preferably United Nations, are highly encouraged to apply;
- For any query please contact: albt@unhcr.org

Interested candidates should submit their applications (Completed UNHCR Personal History (P11) form, P11 Supplement form and Motivation Letter) electronically by e-mail to: albt@unhcr.org or in the sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Str., Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania referring to the Vacancy Notice reference UNHCR: ALB/TIR/18/GS/01.

Deadline for submitting applications is 23rd July 2018, 17:30 CET. Late or incomplete applications received without the above specified documents will not be considered;



Ambasadorja e BE flet për debatin e kohëve të fundit

Vlahutin: Teatri, politika të dëgjojë zërin e qytetarëve

“Qëndrimi ynë, pas analizës”

Ambasadorja e BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin i bëri thirrje qeverisë që të bëjë dëgjesa me qytetarët që të arrihet një marrëveshje për teatrin.

Në një takim në Fier, ajo theksoi mes të tjerash se ka marrë disa letra për këtë çështje, ndërsa shtoi se pas një analize të thellë do të vijë edhe përgjigja nga BE-ja.

“Kemi marrë letra dhe kërkesa që kanë të bëjmë me këtë çështje. Jemi duke bërë një analizë të gjatë ligjore. Këshilla ime do të ishte; dëgjoni qytetarët tuaj, flisni me ta për të gjetur zgjidhje në përfitim të qytetarëve. Përgjigja jonë do të vijë pas një analize të thellë lidhur me çështjen e teatrit. Të diskutohet me qytetarë”, tha Vlahutin.

Ligji për shembjen e Teatrit Kombëtar kaloi për miratim vetëm me votat e mazhorancës, duke hasur kështu në kundërshtitë të madhe nga artistët, por edhe opozita dhe shoqëria civile. Vlahutin ishte e pranishme në një takim të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri në një ndërmarrje sociale e themeluar nga dy organizata të sho-



Ambasadorja e BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin

qërisë civile.

Pak ditë më parë, pas një seancë maratonë me debate, akuzua dhe kundërkauza të ashpra, mazhoranca ka miratuar projektligjin që i hap rrugën zbatimit të projektit për Teatrin e ri Kombëtar që do të ngrihet pas shembjes së ekzistuesit.

Me gjithë kundërshtitë e ashpra në sallën e parlamentit gjatë gjithë ditës, por edhe jashtë sallës nga protestuesit, mazhoranca ka miratuar me 75 vota projektligjin.

Ndërkohë, gjatë momenteve të votimit deputetët e opozitës bllokuan

foltoren e Kuvendit.

Më herët, kreu i grupit të PD Edmond Spaho mori fjalën për procedurë dhe kërkoi të tërhiqet ky projektligj. Por pas refuzimit të mazhorancës, në ato momente opozita bllokoi diskutimet për projektligjin për avokatinë.

Në këto rrethanë, kreu i Kuvendit veprimi si në seancat e shkuara duke kaluar për votim projektligjet pa diskutim.

Pasi mazhoranca kaloi me forcën e kartonit projektligjin për Teatrin, deputetët e opozitës braktisën sallën.



REPUBLIKA E SHQIPERISE BANKA E SHQIPERISE

ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2018

Banka e Shqipërisë fton të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në konkursin e hapur “Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2018”, i dedikuar për studentët shqiptarë të diplomuar gjatë periudhës 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018, brenda dhe jashtë vendit, për punë shkencore në një nga çështjet e ekonomisë monetare e ndërkombëtare, stabilitetit financiar, çështje të integritetit ekonomik të vendeve të Ballkanit në Evropë, politika monetare dhe politikat makroprandiciale të Bankës së Shqipërisë, politika fiskale dhe roli i tyre në ekonomi, sistemi bankar shqiptar, sjelljet e individëve dhe firmave në Shqipëri, si dhe aspekte të ekonomisë në përgjithësi.

Studentët e interesuar duhet të paraqesin në formë elektronike* (pdf) në adresën elektronike public@bankofalbania.org, dokumentet e mëposhtme:

- një letër ku shprehet interesim i studentit për të konkurruar për Çmimin në fjalë;
- Curriculum Vitae;
- abstraktin dhe një përmbledhje të shkurtër të gjetjeve kryesore;
- emrin e udhëheqësit të temës dhe universitetin/fakultetin përkatës;
- temën e diplomës.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve është data 31 tetor 2018.

Për më shumë informacion mbi rregullat e pranimit, lutemi vizitoni faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë www.bankofalbania.org ose shkruani në adresën e emailit public@bankofalbania.org.

* Mesazhi elektronik drejtuar Bankës së Shqipërisë në adresën public@bankofalbania.org duhet t'i referohet “Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2018”.

Opinion *i* Ditës

Masterat profesionalë në fushën e ekonomisë – një ofertë e re e KU ‘‘LUARASI’’

Prof.As.Dr. Leontiev Çuçi



Ligji i ri për arsimin e lartë, ndër të tjera, i dhë një hapësirë më të gjërë dhe një orientim të ri shkollimit profesional duke mundësuar mbushjen e një boshllëku të evidentuar ndjeshëm në nivelet e arsimimit në vendin tonë. Në nivel universitar ky orientim realizohet nga masterat profesionalë, të cilët janë më të përmbledhur në afate kohore, nga 1.5 vjet që ishte më parë, ato realizohen tashmë brenda një viti akademik, gjë që jep mundësi më të spikatura për përmbledhjen e materialit formësues dhe përgënderimin më të madh të tij në përveçsimin më doborës të njohurive praktiko-teorike të ushtrimit të profesionit respektiv. Për më tepër, në tregun tonë, por edhe nga përvojat e tregjeve ndërkombëtare, përgatitjet profesionale në Ciklin e Dytë të masterave profesionale janë më të domosdoshme për veprimitaritet dhe kombinuar të njohurive, ku përveç atyre teorieve dominon veprimitaritet dhe kombinuar të njohurive, ku përveç atyre teorieve dominon veprimitaritet dhe kombinuar të njohurive, ku përveç atyre teorieve dominon veprimitaritet...

të funksionimit të këtyre tregjeve duke evidentuar elementët bazikë të tyre si: “Sigurimi i jetës dhe i pensioneve”; “Sigurimi i jo-jetës”; “Kontratat e sigurimeve”; “Tregjet financiarë dhe tregu i sigurimeve”; “Menaxhimi i riskut në sigurime”; “Drejtimi i biznesit në sigurime”; etj. Cikli i mësimdhënies parashikon edhe njohjen me veprimitaritet praktikë të tregut tonë të sigurimeve, por edhe praktikat e sotme ndërkombëtare të tregut rajonal, të atij evropian e më gjerë.

biznesi i vogël e deri tek korporatat e mëdha; për sistemet e informacionit bashkëkohor në marketing; si menaxhohet cilësia dhe standardet në marketing; cila është psikologjia e marketingut, etj. Një orientim i spikatur do të jetë edhe përfitimi i dijeve me faktorët psikologjikë që ndikojnë në procesin e marketimit dhe të reklamës.

Lidhur me programin e Masterit Profesional në “Financë dhe Menaxhim Risku” studentët do të përgatiten me një material profesionalo-shkencor bashkëkohor dhe mjaft të dobishëm për të kuptuar ndërlidhjen midis problemeve të menaxhimit të financave me riskun financiar. Programi do të japë njohuri të thelluara për konceptet bazë të vlerësimit financiar të projekteve të investimeve dhe aplikimit të metodave dhe të instrumenteve kryesore të analizës së tyre; për identifikimin e riskut për projektet, për firmën dhe për aksonarët; për modelet e analizës së mbulimit të risqeve; etj. Një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet vlerësimit të riskut, analizës së sensibilitetit të tij, nivelit të rentabilitetit, simulimeve të mundshme, etj. Adaptimi dhe aplikimi i këtyre metodave dhe modeleve në shumë projekte të ndryshme investimesh financiare do t’i referohet realiteteve të tregut të brendshëm shqiptar, por edhe të atij ndërkombëtar. Synimi kryesor do të jetë marrja e njohurive të reja në fushën e riskut financiar dhe sidomos të menaxhimit të tij duke patur parasysh proceset e zhvillimit të tregut financiar shqiptar dhe sidomos ato të integrimit të tij në tregun evropian dhe më gjerë.

Nërsa në programin Masterit Profesional në “Kontabilitet” programi përfaqëson një ofertë të re në tregun tonë të kontabilitetit dhe të marrëdhënieve të ndërmjetme të kompanive dhe të individëve dhe të bashkëpunimit me biznesin dhe të tregut evropian dhe më gjerë.

Kështu, Masteri Profesional në “Marketing dhe reklamë” do të ofrojë njohuritë më të fundit në menaxhimin e reklamës të lidhur me marketingun, me mënyrën se si do të sillen konsumatori në këtë lidhje dhe çfarë ndikimesh do të ketë në eficiencën e saj, pra kush ndikon në shumë në kostot dhe sasinë e kërkuar nga konsumatori: marketimi apo reklama. Në raport me Ciklin e Bachelorit studentët do të marrin njohuri të reja në fushën e marketimit dhe të reklamës lidhur me metodologjitë e kërkimit sipas niveleve të strukturave të biznesit duke shkruar nga

tjeve të avancuara të kontabilitetit financiar duke integruar me raste të vazhdueshme nga përvoja aplikativo-studimore. Studentët do të analizojnë çështje të ndryshme komplekse si: transferatat interkorporative për asetet dhe shërbimet jo-korrente; për transaksionet e blerjeve, të investimeve, të borxheve, etj.; të evidentimit financiar të problemeve të pronosisë etj. Të tëra këto çështje dhe të tjera si këto do të synojnë një formësimin sa më të konsoliduar aplikativo-praktik duke ndërlidhur situatat e lëvizjeve dhe zhvillimeve financiare me ato të kontabilitetit bashkëkohor të tyre. Programi synon, gjithashtu, t’i përgatisë studentët për sfidat me cilat do të përballen në botën profesionale ku kontabiliteti merr një rëndësi të veçantë në zhvillimin e karrierës së tyre

duke vënë theksin e duhur mbi zhvillimin si të aftësive të tyre në trajtimin e elementeve pasurorë, në përdorimin e programeve në dispozicion të teknologjisë së informacionit si Excel, ashtu edhe në zhvillimin e sjelljes dhe vlerave individuale të cilat i bëjnë ata profesionistë të aftë dhe me integritet. Të tria programet e reja të masterave profesionale që KU “LUARASI” do të ofrojë për vitin akademik 2018 – 2019 janë hartuar dhe formatuar në mënyrë të tillë që t’i japin hapësirë dhe mundësi çdo studentit të diplomuar në Kolegjin tonë të vazhdojë studimet në Ciklin e Tretë të studimeve në “Master Ekzekutiv” që është dhe ekuivalent me gradën e “Doktorit” të shkencave.

* *Pedagog në KU ‘‘LUARASI’’*



Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

Paketat Super	Super 500	Super 700	Super 1100	Super 1300	Gigastike	Super 1900
Çmimi (me TVSH)	500 Lekë	700 Lekë	1,100 Lekë	1,300 Lekë	1,300 Lekë	1,900 Lekë
Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse)	300	200	2500	3000	400	3500
Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks	300	400	500	3000	400	3500
Minuta Ndërkombëtare				30		60
SMS drejt ALBtelecom Mobile	300	400	1000	2500	400	3000
SMS Kombëtare			500	400		300
SMS Ndërkombëtare						
Internet 3G/4G		300 MB	3 GB	5 GB	5 GB	12 GB
Internet 3G/4G+						3 GB
Përfitime të tjera					10 GB (Social & Chat)	
TV				ALBtv Mobile	ALBtv Mobile	ALBtv Mobile
Vlefshmëria	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t’i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

*Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.**

EKSPOZITA

Michel Setboun - bien venu à Tirana

Nga Luan Rama*

Michel Setboun: Mirëseardhe në Tiranë! Një ekspozitë në Kryeministri, duket diçka joshëse për një artist që vjen nga jashtë, por në atmosferën e një përçarjeje shqiptare, një ekspozitë në një mjedis neutral, apolitik, edhe pse arti i tij është politik, do të ishte më i nevojshëm. Sidoqoftë, Setboun i ka shërbyer një kohe, një epoke, artit të lirisë. Fotografia ka guxuar gjithnjë, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha pikat e nxehta të globit: bota e dhunës, mungesa e lirisë, ajo e popujve të shtypur nga shtetet totalitare kanë qenë gjithnjë në optikën e tij. Ja pse ky artist ka qenë një militant i madh i së drejtës. Fatmirësisht atë e kam njohur në Paris që në vitin 1992 e më vonë. Në shtëpinë e tij, imazhet shqiptare zinin një vend të veçantë dhe padyshim të gëzon fakti që ai ka ardhur të prezantojë fotografitë shqiptare, çka publikut tonë i ka munguar; fotografia historike, qytetare, ajo e jetës së përditshme në vështrimin e dëshpëruar dhe pa rrugëdalje të shqiptarit të viteve 1988-1989-1990. E padyshim, tashmë nuk është koha thjesht e parajetës, sot është koha e analizës, e antropologjisë së fotografike, pasi fotografia është një nga dëshmitë më interesante të kësaj epoke: është imazhi që nuk gënjën, që tregon, atë çka është për-tuar.

Takimi me Michel Setboun është gjithnjë i këndshëm. Ky fotograf i njohur tashmë, me një trup atletik dhe një mirësi që spikat në portretin e tij të qeshur, ky njeri që ka rrahur gjithë botën, nga Uzbekistani, Mongolia, Afganistani, Jemeni, Hong-Kongu, e më pas Mauritaninë, Izraelin, Qipron, Brazilin e dhjetëra vende të tjera të botës etj., kur flet për Shqipërinë ka një lloj ngazëllimi. Duket se Shqipëria është bërë pjesë e jetës së tij, jo pse ai e ka vizituar Shqipërinë me dhjetëra e dhjetëra herë dhe njëjthë pothuaj çdo pëllëmbë të saj, por sepse më shumë se kushdo fotograf tjetër në botë, ai ka depërtuar thellë në jetën dhe historinë e shqiptarëve, jo thjesht si imazh, por në një lidhje shpirtërore që ndihet në çdo



Michel Setboun

Ekspozita në Kryeministri, në një kohë përçarjeje

shkrepje të aparatit të tij, në ngjarje e fate njerëzore, shpesh dramatike, nga kampet e punës dhe gjurmët e mbetura të Spaçit, në pikëtkimin me njerëz të thjeshtë, me plagë të mpiksuras apo njerëz historikë, siç ishte për të edhe fotografimi i Nënë Terezës në Shqipëri. Ai nuk rend pas sensacionit, të bëjë "scoop" apo të dëshmojë histori banale, që jo rrallë i shohim në mediat e huaja për Shqipërinë. Vizioni i tij është humanist, konstruktiv dhe që sheh drejt të ardhmes së këtij populli. Në mijëra e mijëra fotografi të jetës dhe historisë moderne shqiptare, që nga viti 1981 e gjer më sot, arkivi i tij përbën padyshim një vlerë më vete të historisë shqiptare, një kontrast e evolucion ku spikat portreti njerëzor.

Historia e këtij fotografi francez me origjinë hebre është e quditshme, pasi ai kishte studiuar për arkitekturë dhe ëndërronte të bënte diçka për urbanistikën, ndërkohë që pas diplomës në vitin 1976, pasioni e çoi drejt një udhe të re: ai rrëmbeu aparatin fotografik dhe shkoi të fiksonte imazhet e lëvizjes për pavarësi në Angola. Fotografia do të bëhej pasioni i madh i jetës së tij. Nga Angola, ai shkoi në Iranin e trazuar, ku botoi edhe

një nga librat e parë fotografikë mbi Revolucionin Islamik. Pastaj udha e çoi drejt Afganistanit, në malet e Peshavararit, duke përvijuar më vonë në frontin e luftës irano-irakiane, në llogoret e luftës civile të Libanit, në Poloni e më pas në Shqipëri në vitin 1981. "Më intrigojnë gjithnjë ky vend i izoluar, totalitar, ku ishte tepër e vështirë të depërtoje. Por përmes Shoqatës së Miqësisë Francë Shqipëri, në kohën kur punoja për agjencinë SIPA, unë munda të kapërcej kufirin shqiptar". Të hyje atëherë në Shqipërinë e Enver Hoxhës nuk ishte gjë e lehtë dhe hapet e "Sigurimit" ky fotograf do t'i ndjente vite me radhë. Më 1982, pra një vit

më vonë, në Salvador, Setboun do të plagoset, por përsëri, ky njeri kurajoz nuk do të ngronte të shkonte në vendet më të rrezikshme të botës. Fotografia e grishite gjithnjë të fotografonte botën e trazuar, botën në klithje, në shtëzim dhe të revoltuar. Në vitin 1984 u vlerësua me çmimin e Parë të "World Press" për fotografinë.

Michel Setbounin e kam njohur në Tiranë në vitin 1989 apo 1990. Më kishte bërë përshlypje një reportazh i tij për Shqipërinë, ku një nga fotografitë tregonte një fshat që bënte banjë dielli, diku nga plazhi e Golemit rrëzë një bunkerit. Një fotografi domethënëse në atë kohë për sytë e një të huaji, kjo bashkëjetesë e bunkerit me një njeri krejt indiferent ndaj tij. Fotografitë e tij atë kohë botoheshin në shumë revista evropiane e amerikane, pasi ai ishte nga të rrallët fotografë që do ta shoqëronte tranzicionit dhe shembjen e diktaturës në Shqipëri, nga "hapjet" e para dhe refugjatët, në emigrantët që iknin në portin e Durrësit duke i u ngjitur me litarë anijeve e gjer në ditët e shembjes së shtatorit të Enver Hoxhës. Por Setboun do të vinte përsëri në Shqipëri për të fiksuar në objektivin e tij botën shqiptare që filloi të lëvizte drejt ardhmërisë. Ai do të njihete si hallet dhe dertet, si deliret dhe kaosin shqiptar, ashtu dhe vlerat dhe bukuritë e këtij vendi. Një dëshmi dhe eksperiencë e pasur, të cilën ai po e përgatit në një libër që do ta botojë së shpejti në shtëpinë botuese franceze "Martinière".



Por nëse Willy Ronis e shkeli Shqipërinë vetëm një herë, Michel Setboun do ta bënte këtë vend një pjesë të jetës dhe krijimtarisë së tij. Para pak kohësh ai e vizitoi përsëri Shqipërinë. Kësaj radhe me ish-gazetarin e gaztës franceze "Libération" dhe tashmë "Grand reporter", Jacques Maigne, për një reportazh për revistën e njohur evropiane "GEO". "U nisëm me një tjetër ide, - më thotë duke qeshur Misheli, por menduam pastaj se duhej një tjetër imazh për Shqipërinë". Ata i ranë kryq e tërthor Shqipërisë, nga Saranda në Vermosh, nga Përmeti në Korçë, duke kaluar nga Berati, Durrësi dhe fshatrat përreth. Fotografitë e ndërtesave të lyera me bojëra shumëngjyrëshe, Michel Setboun i quan një "terapi kromatike". "Mjaft interesante, apo jo!" - entuziazmohet ai. Titulli i reportazhit të Jacques Maigne në këtë revistë është domethënëse "Një vend që nuk kërkon veçse ta duam" dhe më poshtë në nëntitull që kërkon ta përforcojë këtë ide dhe ku shkruhet: "Nga Tirana, një kryeqytet në transformim të plotë, te fshatrat prej guri ku koha ka ndaluar: takim me një vend që ka mungesë dashurie". Përse vallë kjo mungesë dashurie? Vallë pse shqiptari kërkon të shembë kufijtë e fundit që e ndajnë me Evropën e bashkuar, apo pse ai ndjen një lloj indiference apo mosnjohje?... Dhe me të drejtë gazetari Maigne në këtë reportazh shkruan: "Rrugët e Tiranës ziejnë dhe turma euforike ngjan me simotrat e saj në Romë, Selanik, Marsejë apo Barcelonë. Vendi më i varfër, më i brishti, më i trondituri dhe më i nëpërkëm-

buri i kontinentit ka vetëm një obsesion: integrimin në Evropë, shpejt dhe me çdo kusht!". Në këtë reportazh dhe fotografitë që e shoqërojnë, Shqipëria na shfaqet ndryshe, larg klisheve të dëmshme, të mërziut dhe irritueses të banditizmit, klandestinëve, kalashnikovëve, krimtimit dhe prostitutave. Jo pse krimi nuk ekziston, si në çdo vend tjetër të botës, por sepse shqiptari, kjo tokë, kjo botë gjëzore ka edhe gëzim, ngjiz punë e dashuri, virtyte, histori e kulturë, si një nga popujt më të vjetër europianë. Ja pse atyre do t'u tingëllojnë patetike, por të vërteta, fjalët e poetit Ervin Hatibi, i cili në Tiranë u thotë: "Në kemi kaluar nga akullnaja në kaos, nga komunizmi në hijë. Po, plaga ime është Shqipëria, unë jam i çmendur pas gjuhës së vendit tim, i çmendur për bukuritë, misteret dhe njerëzit e tij. A arrini ta kuptoni këtë...?"

Po, sytë e fotografi Setboun dhe gazetari Maigne e shohin ndryshe Shqipërinë, pasi në itineraret e tyre shqiptare ata gjetën një popull që kishte dëshirën e ndërimit, të emancipimit, të integritit, të paqes. Ja pse që në fillim të reportazhit të tyre "Shqipëria mesdhetarja", shkruhet: "Ajo ishte e izoluar ndaj të huajve gjatë pothuaj një gjysmë shekulli dhe ne kemi harruar se me 427 km bregdet që ajo ka, Shqipëria është një nga vendet më të bukura të Mesdheut. Shqipëria duhet zbuluar para se ky vend të bëhet një vend turistik "à la mode". Një thirrje publikut të huaj për ta parë ndryshe Shqipërinë. Fotografitë e Michel Setboun e dëshmojnë këtë.

*Studiues

Sërish në "ruletën" e penalltive

Kroacia eliminon Rusinë, përsërit suksesin e vitit 1998

Rusia dhe Kroacia për balleshin mes tyre në Soçi për të përcaktuar gjysmëfinalisten e fundit dhe rivalen e Anglisë, ndërsa ashtu siç parashikohej, ndeshja ishte e balancuar. Kroacia në përbërje me më shumë talent sesa Rusia, duhej t'i bënte llogaritë me të zotët e shtëpisë, të njëjtë si Anteu, e marrin forcën nga toka e tyre. Kjo pasi të besuarit e Çerçesovit e nisnin ndeshjen me të mirë sesa Kroacia, madje kalonin të parët në avantazh, kur në minutën e 31-të Cherishev shënon një gol të hatashëm nga jashtë zonës me të ma-

jten, duke e lënë të shtangur portierin Subasiç. Megjithatë reagimi i ballkanasve është i menjëhershëm dhe pak minuta më vonë rikthejnë barazeshën me Kramariç, që shërbehet shkëlqyeshëm në zonë nga Manxukiq dhe me kokë thyen Akinfeevin. 1-1 dhe ekipet shkojnë në pushim të ndeshjes në baraspeshë. Me fillimin e pjesës së dytë Kroacia është më mirë e orientuar dhe e ngacmon disa herë portën e Akinfeevit për të kulmuar në minutën e 60-të, kur vetëm shtylla e ndal Perisiçin nga goli i avantazhit. Më pas Xjuba për Rusinë shfaqet rrezikshëm me kokë, ndërsa deri në fund të kohës së rregullt rastet do të jenë të pakta, me Subasiçin që grushton tenta-

tivën e Smolovit. Skuadrat shkojnë në shtesa, e dyta ndeshje radhazi që kërkon 30 minuta ekstra si për Rusinë ashtu edhe për Kroacinë, pasi edhe në 1/8-at ndaj Spanjës e Danimarkës u nevojiten dy pjesë nga 15 minuta e më pas penalltitë për të përcaktuar fituesin. Smolov nuk përfitojnë nga gabimi i Lovren në minutën e 100-të, por duket se nuk ka shumë energji në këmbët e tij sul-

muesi rus. Kroacia do të kërkojë të shmangë penalltitë dhe në minutën e 101-të Vida me kokë gjuan dhe Çorluka devijon lehtë, duke e çuar topin në rrjetë. 2-1 dhe ballkanasit janë një hap larg përsëritjes së suksesit të vitit 1998. Edhe Rusia përipiqet po me kokë, por Jerokhin nuk do të devijojë saktë. Por kjo ndeshje emocionet e vërteta i paska ruajtur pikërisht për shtesat. Minuta e 115-të, Piv-

ariç prek topin me dorë aty ku bashkohen vijat e 16-metërshit dhe Alan Xagojev harkon për kokën e Fernandez, i cili shfaqet i pamarkuar në zonë dhe barazon gjithçka duke bërë të shpërthejë nga gëzimi "Fisht Olimpik Stadium" i Soçit. 2-2, por Rusia duket se kërkon të shmangë penalltitë. Zobnin provon nga hyrja e zonës, Subasiç ndal me vësh-tirësi dhe u kërkon shokëve qetësi në këto minuta të fun-

dit, minuta që nuk sjellin asgjë dhe i dërgojnë ekipet për të dytën herë radhazi te penalltitë. Smolov gabon për rusët, ndërsa Brozoviç shënon. Baraspesha kthehet te penalltitë e dyta, ku Xagojev shënon, por gabon Kovaçiç. Heroi i Rusisë në shtesë, Fernandez, gjuan penalltinë më të keqe të këtij Botërori dhe e nxjerr jashtë, ndërsa Modriç me shumë fat arrin të thyejë Akinfeevin. Më pas, të gjithë gjuajnë saktësisht, përfshirë dhe Rakitiçin, që ka penalltinë e fundit, të cilën e kthen në gol dhe dërgon Kroacinë në gjysmëfinale, aty ku e pret Anglia, ndërsa Rusia largohet me kokën lart nga botërori.

Për herë të fundit kishin kaluar çerekfinalet në vitin 1990. Tifozët besojnë më shumë se kurrë

Angli, tashmë nuk është më një ëndërr!

2-0 Suedisë dhe gjysmëfinale për ishullorët



Jeton Selimi

A ta besojnë! Tifozët an glezë e dinë shumë mirë se "Tre Luanët" nuk kanë klasin e Runit apo të Ouenit. As mesfushën e blinduar nga Xherrard e Lampard, sikurse në qendër të mbrojtjes nuk është më dys-hja Terri-Ferdinand. Por djemtë e drejtuar nga Sutgejt, ndonëse nuk kanë shumë ndeshje me fanellën e përfaqësueses, po dhurojnë emociione të jashtëzakonshme në ishull. Anglia shkon në gjysmëfinale pas 28 vitesh mungese dhe është vetëm një hap larg finale. Të vetmen finale të luajtur, ata e kanë fituar në vitin e largët 1966, plot 52 vjet më parë!

Ndaj Suedisë nuk ishte aq e lehtë saç tregon rezultati përfundimtar. Kjo sepse Anglia kishte pak a shumë të njëjtën shtaturë loje si nordikët, por diferencën e bënë këmbët e shpejta të Lingard e Stërling, të aftë të krijojnë panik në mbrojtjen suedeze. Goli i parë do të vijë në minutën e 30-të, kur në zhvillimet e një këndoreje, Magua-jër gjendet i pamarkuar dhe me kokë thyen Olsonin. 1-0



dhe Anglia në epërsi. Madje fundi i pjesës së parë është shumë i mirë për ishullorët, që mund të kishin shënuar tjetër gol, por nuk ia dolën.

Pjesa e parë mbyllet me epërsinë e Anglisë, ndërsa në të dytën Suedia është më ofensive, madje mund të kish-të shënuar me Berg, por Pik-



ford edhe njëherë është monumental. Në aksionin tjetër të rëndësishëm, Anglia shënon, sërish me kokë. Kësaj radhe është Dele Ali që shfrytëzon


harkimin e Lingardit dhe mposht Olsonin duke siguruar rezultatit. Suedia mund të rikthehej në lojë pak minuta më pas, por edhe njëherë Pik-

ford shpërblen besimin e dhënë, duke i kohuar Klasonit një gol të sigurt. Madje edhe atëherë kur Anglia e humbet topin rrezikshëm në mesfushë, është gardiani i Evertonit që mban të paprekur kuadratin e tij, si në rastin e minutës së 72-të. Suedia duket e dorëzuar, nuk mund të bëjë më asgjë përpara Anglisë, ndërsa minutat kalojnë pa kërcënime serioze në portat respektive deri kur Bjorn Kuipërs të vërshëllejë fundin e 90 minutës në "Samara Arena" dhe të legjitimojë kalimin e "Tre Luanëve" në gjysmëfinale, me anglezët që duket se kanë të gjitha mundësitë ta kthejnë vërtet në shtëpi trofeun e madh.

Suedezi i detyruar të veshë fanellën e Anglisë

Ibra humbet bastin me Bekamin

Zlatan Ibrahimoviç është i veçantë dhe këtë e tregon sidomos kur është jashtë fushës së lojës, me fjalët e tij. Ai ka shfrytëzuar ndeshjen e nesërme mes Suedisë dhe Anglisë për t'i sugjeruar Devid Bekam një bast mjaft të veçantë mes të dyve. Njëpërmytet rr-jeteve sociale, sulmuesi suedez i ka lëshuar dorashkën e sfidës mikut të tij, i cili ashtu si Ibra, në të kaluarën ka qenë kapiteni i përfaqësueses. "Nëse Anglia fiton, unë të ofroj drekë kudo që të dëshirosh ti në botë. Por



nëse fiton Suedia, atëherë ti do të më blesh mua çfarëdo që dua të IKEA", ishte basti

që propozonte sulmuesi suedez, i cili këtë Botëror po e ndjek si spektator. Nuk ka vonuar edhe përgjigja e Bekam, i cili ka pranuar sfidën dhe e ka bërë më interesante. "Nëse Suedia fiton, unë personalisht do të dërgoj ty të IKEA të blesh çfarë të duash për vilën tënde të re në Los Anxhe-los. Por kur Anglia të fitojë, unë dua që të vish të shohësh një ndeshje të Anglisë në Uembl me një fanellë të Anglisë veshur", ishte përgjigja e anglezit e shoqëruar me një shtrengim duarsh. Tashmë Zilatan duhet të mbajë fjalën!

REAGIMI

Mediat braziliiane janë treguar të pamëshirshme me kombëtarin e tyre pas eliminimit të pësuar mbremë nga Belgjika. Emblamatik është titulli i zgjedhur nga Globo-sporte, që shpreh njëkohësisht habinë dhe zemëratën me një "Çfarë drejtin!" dhe vë në bankën e të akuzuarve Fernandinjon, Paulinjon Gabriel Zhezus, autorë të një ndeshjeje negative, sikundër edhe Nejmar, që nuk ka bërë asnjë diferencë. "Fundi i një ëndrre" titullon Lancenet, por që merr në mbrojtje Nejmarin. "Numri 10 ka


Eliminimi, mediat dërrmojnë Brazilin

luftuar, ka kërkuar hapësirat dhe ka gjuajtur, por portieri bëri një pritje të shkëlqyer". Më i thjeshtë titulli i "Folhas". "Vetëm skuadra europiane në gjysmëfinale" dhe më pas vijon komentit "Nejmar sheh t'i largohet mundësia që të bëhet lojtar më i mirë në botë". Por edhe mediat europiane i kanë kushtuar shumë hapësirë eliminimit të pretendentit numër një. "Selecao" shkruan "Gazzeta Dello Sport", që bën një lojë

fjalësh me nofkën e përfaqësueses së sambës dhe fjalësh mirrupafshim. "L'Equipe" shkruan "Djaj-të efikasë", ndërsa "Marca" shoqëron foton e Nejmarit të gjuajtur me titullin "Roberto Martinez godet Botërorin", Katalan-sja "Mundo Deportivo" ka zgjedhur, gjithashtu, një lojë fjalësh, "Neymal", ndërsa portugezia "Abola" sërish zgjedh Nejmarin si foto ilustruese shoqëruar me titullin "Na ishte njëherë".

E DIEL

8 Korrik
2018



NGA ARMAND PLAKA

Sot duket diçka nor male, ndoshta fare e natyrshme, por sig urishtë edhe tejet emocionuese e plot dobi për këdo që arrin të përfitojë një bursë studimore apo të ketë mundësi të kryejë studime në Gjermani e Austri.

Të dyja vendet sot kontribuojnë vazhdimisht me programe bursash në mbështetje të të rinjve shqiptarë në shumë fusha studimore dhe jo vetëm. Por dikur të dyja vendet ishin një: Gjatë Luftës së Dytë Botërore ato ishin pjesë e Rajhut Gjerman, ish-Perandorisë naziste, e cila duket se edhe në vitin e pestë të luftës, vijonte të jetonte në dukje në normalitet, duke përcjellë jo vetëm breza studentësh të vetët, por edhe ata të huaj, kryesisht të vendeve aleate të Boshtit, ose ata neutralët apo dhe të ashtuquajturit “*deutschfreundlich*” (miqësorë ndaj gjermanëve).

Megjithatë, e habitshme të duket kur e mendon se ndër- sa vendi ishte zhytur në kaos, kur fatet e luftës tashmë dukeshin thujtë të vullosura dhe nga ardhja e komunistëve në pushtet nuk mbeteshin as edhe tre - katër muaj, shumë të rinj shqiptarë zgjidhnin të linin atdheun për të shkuar me studime - duke përmbyshur kësajsoj ëndrrat e tyre - në Rajhun Gjerman.

**PËR STUDIME NË MES TË LUFTËS TEK HUMBËSIT E PASHALLUR?!
Ishite dhjetëditëshi i fundit i gushtit 1944, kur një grup studentësh (bursantësh) shqiptarë nga çdo anë e Shqipërisë, me valixhet në duar, ishin grumbulluar para Hotel “Dajtit” në Tiranë, për t’u nisur në mënyrë të organizuar e me gjasa në mënyrë ceremoniale, drejt destinacioneve të tyre përkatëse në Ish-Rajhun e Fyhrerit, i cili s’kishte as një muaj që kishte qenë viktimë e një komploti dhe një atentati që për pak i mori jetën, e që mund të kishte shërbyer në fakt për t’i dhënë fund luftës.**

Të paktën kjo është ajo që përftojmë nga një lajm i shkurtër botuar në “Lirija e Shqipnis”, gazetën e vetme në gjuhën shqipe të Armatës

Gjermane në Shqipëri (Wehrmacht). Më konkretisht në raportin e saj me këtë rast (shih: Studim në zemrën e Evropës- Si shkojnë studentat shqiptarë në Gjermani?, Gazeta “Lirija e Shqipnis”, 21 gusht 1944, fq. 1), shkruhej:

“S’ka shumë kohë q’u muarr kjo fotografi përpara Hotel Dajtit, e me gjithë këtë studentat sh-

qiptarë në Gjermani po kalojnë kohët më të mira dhe disa syresh po shohin në vëndin e studimeve të tyre, një Atdhe të dytë. Kohët e fundit i vizituan studentat shqiptarë edhe Pater Harapi dhe Ministri i Brëndshëm, Deva. Të dy personalitetet e nalta qëndruan midis bashkatdhetarvet të tyre dhe u

dhanë atyre përsëritjet e Atdheut, dyke u interesuar për nevojat dhe dëshirat e cilitdo. Kanë aritur shumë letra nga Gjermania. Nër të gjithë shprehet gëzimi i math q’u ngjall studentvet shqiptarë jeta e re dhe interesante në Gjermaninë krijonjëse në të 5 vit të luftës. Disa çfaqin enthu-

asmin e tyre të veçantë që patën rast të ndodhen pikërisht në zemrën e Evropës, në qendrën e punës së palodhshme për mbrojtjen e kontinentit dhe t’a kuptojnë më mirë rëndësinë dhe qëllimin e kësaj lufte”.

→Vijon në faqen 14

1944/ Kur studentët SHQIPTARË STUDIONIN në Vienë me bursat e RAJHUT!

{ Në këtë numër: ALEKSANDËR SOLZHENICIN ARDHUR NGA KUJTIM MORINA, DEMIR GJERGJI, BAJRAM SEFAJ, MAKS VELO, ARDIAN NDRECA, ETJ... }

D

DOSSIER

Është dhjetëditëshi i fundit i gushtit 1944 dhe një grup bursantësh shqiptarë të grumbulluar para hotel "Dajtit" në Tiranë, nisen në mënyrë të organizuar dhe disi ceremoniale, shpjegon autori, drejt destinacioneve të tyre përkatëse në ish-Rajhun e Fyhrerit. Kjo është një histori e patreguar më parë dhe autori mundohet të na sjellë sa më shumë detaje. Është koha kur vetë Fyhreri s'kishte as edhe një muaj që kishte qenë viktimë e një komploti dhe një atentati që për pak i mori jetën, e që mund të kishte shërbyer, në fakt, për t'i dhënë fund luftës...

1944/ Kur studentët shqiptarë studionin në Vienë me bursat e Rajhut!

NGA ARMAND PLAKA

Vijon nga faqja 13

Sidoqoftë, rezultun paksa e paqartë, në mos edhe manipulativ e sjellë si lajm në këtë mënyrë, pasi ndërkaq prej më shumë se një muaji Xhafer Deva, sikurse dihet, nuk ishte më as pjesë e qeverisë së kryesuar tashmë nga Figjiri Dine, e as Ministër i Brendshëm (ai kishte dhënë dorëheqjen qysh më 18 korrik 1944). E vërteta është se sikurse do të shohim edhe më poshtë, Xhafer Deva dhe anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar të kohës kishin qenë vërtetë për vizita e takime pune në Rajhun Gjerman e posaçërisht në Vienë me studentëve e bursantëve shqiptarë, por kjo kishte ndodhur muaj më parë, në maj 1944.

Pavarësisht se artikulli pohon se "fotografia para Hotel Dajtit është marrë pak kohë më parë", ndërsa shënohet ndërkaq data 21 gusht 1944, duket në të qartazi tendenca propagandistike për të mbajtur gjallë ndër shqiptarët idenë se Rajhu jo vetëm që nuk po kapitullon, por është në gjendje madje të sigurojë edhe vijimin normal të punës e studimeve, sikurse ndodh në një vend normal në kohë paqeje, duke joshur në këtë mënyrë shqiptarët.

MUSTAFA KRUIJA: NË 1943, GJERMANËT AKORDUAN 100 BURSA!

Akoma më interesante ngjan të jetë kjo prurje kur shumë vite më vonë, ish-Kryeministri "kolaboracionist" Mustafa Kruja, në kërkesën që i parashtronte qeverisë amerikane për të përfutur të drejtën për azil politik dhe qëndrim të përhershëm në SHBA, në vitin 1952 (shih: Letra e Mustafa Krujës: Pse bashkëpunova me fashistët!, Gazeta Panorama, 2 maj 2014), duke dashur të verë në dukje pikërisht diferencën mes italianëve dhe gjermanëve në trajtimin e shqiptarëve, pohonte diku në lidhje me këtë çështje se: "Më 1943, ata i dhanë rreth njëqind bursa studimi disa të rinjve shqiptarë që donin të shkonin të studionin në Vienë, ashtu siç kishte bërë Austro-Hungaria gjatë pushtimit më 1916-1918".

Edhe pse nuk mund të jemi të sigurtë, prej saj mësojmë megjithatë një fakt: se këta të rinj do të duhej të shkonin të gjithë në një destinacion, pra drejt Vienës, duke mos prekur me shumë gjasa pjesët e tjera të Rajhut, përfshirë këtu edhe Berlinin. Gjithashtu, nuk mund t'a dimë nëse kontigjenti i mësipërm, që kishte dalë me valixhe para Hotel Dajtit (në gusht apo para gushtit 1944), ishte pjesë apo jo e kësaj marrëveshjeje dhe a përbënte ai pra ndoshta edhe kontigjentin e fundit që po përfitonte prej saj, duke pasur parasysh se ç'do të ndodhte në muajt në vijim.



Pamje nga Tirana gjatë verës së vitit 1944, gjatë kohës së pushtimit gjerman, nga koleksioni i fotoreporterit të Wehrmachtit, Georg Fruhstorfer.

XHAFER DEVA PËRSHËNDET STUDENTËT SHQIPTARË

Duke u zhvendosur në kohë, vetëm pak muaj më parë, nga një tjetër burim, këtë radhë duke shfrytëzuar mediat e Rajhut, apo më saktësisht ato vieneze (Shih: "Deutsch-Albanischer Abend" "Kleine Volkszeitung", 28.05.1944, fq. 7.) në një artikull me titull: Mbrëmje gjermano-shqiptarë!, na rezultun se kontigjenti të cilin për-

Pritja në Vienë

"Deutsch-Albanischer Abend" "Kleine Volkszeitung", 28.05.1944, fq. 7. në një artikull me titull: Mbrëmje gjermano-shqiptarë!, shkruan se kontigjenti të cilin përmend Kruja në relacionin e tij të vitit 1952, thuhajse ishte përbushur tërësisht dhe se ata ishin bërë tashmë pjesë e një pritje zyrtare ku mermin pjesë edhe anëtarët e një delegacioni të nivelit të lartë (kryesuar nga Ministri i Brendshëm, Xhafer Deva) të mbërritur nga vendlindja dhe konsulli shqiptar në Vienë, Kolë Rrota (në artikullin origjinal citohet si Nikolaus Rotta), një veprimtar i hershëm i kolonisë shqiptare në ish-kryeqytetin e Monarkisë dualiste.



Ish-Ministri i Brendshëm në kohën e pushtimit gjerman, Xhafer Deva

Faksimile e artikullit me titull: Studim në zëmrën e Evropës- Si shkojnë studentat shqiptarë në Gjermani?, botuar në gazetën e Armatës Gjermane në Shqipëri në gjuhën shqipe, "Lirija e Shqipnis", 21 gusht 1944.

mend Kruja në relacionin e tij të vitit 1952, thuhajse ishte përbushur tërësisht dhe se ata ishin bërë tashmë pjesë e një pritje zyrtare ku mermin pjesë edhe anëtarët e një delegacioni të nivelit të lartë (kryesuar nga Ministri i Brendshëm, Xhafer Deva) të mbërritur nga vendlindja dhe konsulli shqiptar në Vienë, Kolë Rrota (në

artikullin origjinal citohet si Nikolaus Rotta), një veprimtar i hershëm i kolonisë shqiptare në ish-kryeqytetin e Monarkisë dualiste.

Duket se ish-ministri i Brendshëm Deva, i cili në Tiranë kishte kundërshtarë të fortë edhe brenda radhëve të qeverisë, i përfshirë ndoshta edhe nga euforia, pasi vlerësohej e njihej si i preferuari dhe besnik i gjermanëve, pohon gjatë takimit se shqiptarët tashmë po kontribonin në fitoren e Rajhut Gjerman, si një shpërblim për atë që austro-hungarezët kishin bërë dikur në përkrahje të tyre, edhe pse Shqipëria zyrtarisht njihej si vend "neutral".

Më konkretisht aty shkruhej: "Me rastin e prezencës së tri ministrave shqiptarë, dhe të 93 studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme shqiptare të sapombërritur së fundmi këtu në Vienë, Shoqata Gjermano - Shqiptare e Punës në Vienë, organizoi të premtën me këtë rast në mbrëmje, në ambientet e Zyrave të Shërbimit të Jashtëm, një pritje zyrtare. Presidenti i Shoqatës së Punës, Prof. Dr. Bernatzik, tha gjatë fjalës së tij të përshëndetjes ndër të tjera se viti në vijim për Shqipërinë ka bërë të mundur atë që shqiptarët, të cilët kanë qenë nën thundrën e regjimeve të huaja, që kanë luftuar e janë gjakosur prej shekujsh, Lirinë. Por Vienezët sidomos i ka prekur veçanërisht shumë fakti se Shqipëria e pavarur vendosi që të qëndrojë e lidhur tek tradita e moçme e që ta dërgojë sërish rininë e saj drejt Vienës, në mënyrë që ata të kryejnë këtu studimet e tyre. Vienna do të bëjë më të mirën e vet të mundshme, që studentët shqiptarë këtu të ndihen sa më mirë, e që t'i përmbyllin studimet po aq mirë sa rinia jonë. Ministri i Brendshëm shqiptar, Xhafer Deva, falenderoi për mikpritjen dhe theksoi se shqiptarët gjatë kohës para Luftës së Parë Botërore ishin përkrahur nga Austro-Hungaria dhe sidomos nga Vienna, dhe tashmë kësajsoj vetëkuptohet se po jepnin kontributin e tyre për fitoren e kombit gjerman. Në emër të kolonisë shqiptare të Vienës, më pas përshëndeti Prof. Dr. Malochi. Një program i këndshëm muzikor i dha mbrëmjes një karakter festiv. Ndërmjet e veçantë të nderit, gjendej edhe konsulli shqiptar në Vienë, Nikolaus Rotta si dhe drejt-



Faksimile e Gazetës "Lirija e Shqipnis", 21 gusht 1944



Faksimile e gazetës austriake, asokohe pjesë e Rajhut Gjerman, "Kleine Volkszeitung", 28.05.1944, ku gjendet edhe raporti me titull: Mbrëmje gjermano-shqiptare!

tues të Departamentit të Kulturës në Bashkinë e Vienës".

MARRËVESHJE DYPALËSHE PËR RIORIENTIMIN E EKONOMISË SHQIPTARE

Vetëm një ditë më parë (shih: "Eien Mittler zëischen Albanien und dem Reich", Neues Eienner Tagblatt, Nr. 145, 27 maj 1944, fq. 4.) në një tjetër artikull me titull: *Viena, ndërjetëse mes Shqipërisë dhe Rajhut Gjerman!*, në fund të raportit, i cili në fakt ishte fokusuar tek bashkëpunimi ekonomik mes dy vendeve dhe riorientimi i ekonomisë shqiptare në realitetet e reja që diktonte kësajsoj koha, e ku bëhet fjalë për një takim po në Vienë të Ministrat të Brendshëm Xhafer Deva, atij të Ekonomisë Kombëtare, Ago Agaj, dhe të Dërguarit me Punë të Shqipërisë në Berlin, Rrok Gera, shkruhet se: "Në fund mysafirët përjetuan nga afër kushtet në konviktin ku do strehohen studentët shqiptarë në Vienë".

Duket pra se ndoshta vetë ky kontigjent ishte pjesë e zbatimit të një marrëveshje, e cila mund të kishte shumë kohë që ishte lidhur, menjëherë pas mbërritjes së trupave gjermane në Shqipëri në tetor, apo nëntor 1943.

EDHE SANDËR PROSI NË FOTON PARA HOTEL DAJITIT?

Nëse do kemi parasysh pohimet e të birit të aktorit të madh shqiptar, Sandër Prosi (shih: E vërta e vdekjes së aktorit të madh Sandër Prosi në sheshxhirim, Gazeta "Shqiptarja.com", nga Dhuratata Hamza, 1 prill 2018, fq. 10-11) mund të marrim me mend se pikërisht në këtë kontigjent me valixhe në dorë para Hotel Dajtit në ato ditë fundgusht 1944, mund të ketë qenë edhe aktori ynë i madh, shuarja e të cilit në 1985, akoma mbart në vetvetë një lloj misteri. Ja ç'është më konkretisht, Aristidh Prosi:

"Shumë pasione ka pasur, ndërta në kinema ai u kthye pas dy viteve të studimeve në Vienë. Nuk i ka mbaruar studimet, dhe ka ardhur në Tiranë më 11 janar të vitit 1946, ditën që Shqipëria u bë Republikë. Babi erdhi nga Bari dhe sheh se në Portin e Barit kishte shumë shqiptarë nacionalistë që po largoheshin nga Shqipëria. "Po ti ku vete? I thanë ata". "Në Shqipëri përgjigjet babai". "Po atje e kanë marrë pushtetin komunistët, ç'të duhet ty të shkosh?.. i thonë. Por babai erdhi megjithatë sepse kishte nënën këtu dhe ajo kishte shumë mall për të".

KORRESPONDENTI I RAJHUT: TIRANA DHE SHQIPËRIA TË KUJTON VIENË!

Ajo çka ndodhi më vonë tashmë dihet nga të gjithë dhe tradita e gjatë e lidhjeve të shqiptarëve me botën gjermanike, duke e shfrytëzuar veçanërisht si një terren shumë të pasur për të përmbushur ëndrrat e tyre rinore në lidhje me mirëarsimin, duket se u ringjall më me forcë pas rënies së sistemit monist në Shqipëri.

Pa dashur t'i hyj shifrave e statistikave zyrtare për të bërë krahasime mes kohëve e epokave, ia vlen të citojmë në fund edhe një pasazh shumë domethënës shkëputur po nga një gazetë vieneze e vitit 1944, (shih: Extra Prima Wiener "Hochquellenwasser" in Tirana- In Albanien wird man allenthalben an Wien erinnert!, Alfred Rother, "Kleine Volkszeitung", 28.06.1944, fq. 4) në një artikull të sjellë nga një korrespondent ushtarak i Rajhut në Tiranë, që mban si nëntitull: *Në Shqipëri të kujtohet ngado Vienna!* në të cilën shkruhet:

"Të dëgjosh Valsin e Shtrausit dhe këngët e Grinzing-ut dhe Sievering-ut, në kafenet e panumërta të kryeqytetit Tiranë, nuk të thotë shumë, edhe pse ne gëzohejmë prej këtyre faktit. Muzika vieneze sot është bërë padyshim pjesë e trashëgimisë botërore dhe dëshirohet ngado. Por në mënyrë të veçantë, të bën përshtypje sidoqoftë kur sheh se nga dritarja e një shkolle fshati në Shqipëri, tingëllojnë nga jeta e pastër fëmijore kënga e "Princ Eugen"-it. Rinia shkollorë di të këndojë këtu disa këngë tradicionale vieneze, të cilave sidoqoftë u vishen tekste patriotike në shqip. Por habitësh edhe për numrin relativisht të madh të shqiptarëve, të cilët flasin një gjermanishtë të mirë dhe me një dialekt të pastër vienez. Me krenari zyrtarët dhe nëpunësit shtetërorë pohojnë se kanë studiuar në Vienë. Qysh nga koha e pushtimit turk, të cilin një pjesë e inteligjencës shqiptare nuk e shihnte me sy të mirë, në familjet feudale të vendit ishte kthyer tashmë në traditë t'i dërgonin fëmijët për shkollim në Vienë. Edhe sot e kësaj dite, nuk ka ndryshuar shumëçka nga ajo traditë".

*Autori është ish-bursant i Fondacionit "Konrad Adenauer" dhe i Bundestagut Gjerman në Berlin.

**T
TEATRI**

E veçanta e godinave të Teatrit është se paçka vlerave arkitektonike, asnjë zë potent i arkitekturës nuk i ka nëpërkëmbur ose përkrahur si të shëmtuara. Dhe fakti se këto ndërtesa kanë mbijetuar përbën një shitesë vlerash për to dhe objektin primar të tyre...



Pse duhet të qëndrojë godina e teatrit?!

NGA BEN ANDONI

Janë bërë kaq shumë zëra për teatrin dhe ka kaq shumë kundërshti në lidhje me fatin e godinës saqë është e vështirë sot të përmbledhësh një rezultante. Sa zëra ka për prishjen e tij, po aq ka edhe për mosprishjen e tij. Sa zëra ka për kushtet e këqija të ngrehinës, po aq ka edhe mundësinë e restaurimit të teatrit aktual. Më e pandershmja nga të gjitha ka qenë përfshirja dhe përdorja që politika u ka bërë palëve të përfshira. Nëse do të jesh brenda protestës do të kuptosh grupet e interesit të ashtuquajtur të vogël, ata që presin të bëhen funksionarë dhe u pëlqejnë t'u shkelin syrin Opozitës apo të tjerët syresh që janë të lidhur me pushtetin e Socialistëve. Është kaq e frikshme përdorja e artistëve prej politikës dhe justifikimet patetike të shumë syreshëve, që të bëjnë të kuptosh se pse shumë prej tyre shërbenin me zell si punëtorë partie në propagandën e frikshme që bëri komunizmi ndaj njerëzve. Dhe, për fat, mjafton të shikosh kanalet i sheh shumë syresh në role aq të mira për të treguar Njeriun e Ri dhe supremacinë e komunizmit.

Po ndërtesa? Ajo është një ngrehinë e ndërtuar në kushte të caktuara, por që megjithë arsyet që shkojnë për ta prishur apo për të mbajtur, ajo i ka rezistuar kohëve, kapriçiove të tokës (Tirana ka pasur disa tërmete me magnituda të larta gjatë kohës së ekzistencës së tij) dhe orekëve të pushtetarëve. Fashistët e përdorën sipas interesave të tyre për atë edukimin e tyre specifik pas punës Komuniste e funksionalizuan që nga kinemaja, gjyqi ushtarak dhe më në fund zuri vend si teatër; ndërsa e ashtuquajtura Demokracia përveç se teatër, edhe për bingo etj.

E veçanta e godinave të Teatrit është se paçka vlerave arkitektonike, asnjë zë potent i arkitekturës nuk i ka nëpërkëmbur ose përkrahur si të shëmtuara. Dhe, fakti se këto ndërtesa kanë mbijetuar përbën një shitesë vlerash për to dhe objektin primar të tyre. Ato janë njëjtësuar me kompleksin e ministrive, ndërsa një zë interesant i arkitekturës shqiptare, Artan Raça do të shprehej pak ditë më parë: "Teatri, ashtu si edhe Kinemaja, janë objekte që prodhojnë marrëdhënie dhe infektajnë në një masë tepër të madhe jetën e qytetit dhe të njerëzve të tij. Duke pranuar metaforën arkitekturore se përdoruesit e parë të arkitekturës nuk janë ata që e banojnë, por ata që janë jashtë saj, mund të themi se Teatri Kombëtar ka krijuar një marrëdhënie të gjatë dhe të përhershme me qytetin dhe njerëzit dhe e gjithë kjo marrëdhënie materializohet te kjo ndërtesë dhe te ky kompleks, prishja e të cilit do të merrte me vete tërë këtë histori dhe do të krijonte një boshllëk tepër të madh, që nuk mund ta mbushë asnjë masë e re betoni.

Mjafton të kujtojmë skenën e filmit "Nuovo Cinema Paradiso" të Tornatores për të kuptuar boshllëkun dhe trishtimin që lë prapa prishja e objekteve të tilla në qytet dhe në jetët e njerëzve, një metaforë kinematografike, të cilën ky qytet e ka provuar më shumë se një herë. Pra, duke gjykuar ruajtjen e këtij kompleksi si gjënë parësore, nuk jam fare i interesuar për atë që propozohet të vijë prapa.

Së pari, sepse ashtu si thotë Manzoni, jo gjithmonë ajo që vjen prapa është progres, por dhe sepse për njerëzit joprofesionistë (por nganjëherë edhe për ata), si edhe për ata që marrin vendime, simulara e asaj që do të ndërtohet kur në pyetje është prishja apo jo e asaj

që ekziston, është tepër e rrezikshme dhe joshëse. Shock and Awe, është një taktikë ushtarake e bazuar mbi demonstrimin e fuqisë dërrmuese dhe shfaqjeve spektakolare të forcës për të paralizuar perceptimin e kundërshtarit në fushën e betejës dhe për të shkatërruar vullnetin e tij për të luftuar...".

Një nga arsyet pse godinat e teatrit, si ndërtesa të vjetra, janë tërheqëse për ne konsiderohet vjetërsia dhe forca e tyre duke qenë të pazvëndësueshme në rolin funksional që kanë fituar. Një ndërtesë që ka përjetuar atë histori përmes vetë përfshirjes së saj konsiderohet si vetë historike. Godina e ka kaluar atributin e saj. Ajo është dëshmitarja materiale e ngjarjeve të veçanta, kohëve dhe shfaqjeve të ndryshme. Godina e Teatrit është në një farë mënyre produkt i një nostalgjie për të kaluarën, që gjithnjë do të idealizohet nga brezat e ndryshme të tiranasve, por jo vetëm.

Në dukje naive për arkitektët ajo përmban elementë interesantë, që i bëjnë nder elementeve të arkitekturës së Tiranës së hershme moderne, sipas shkrimit të Raçës. Mbi të gjitha, godina e Teatrit është përfaqësuesja e një arkitekture, që qyteti jonë, do ta kishte për nder ta mbarte.

Anipse, zërat e shumtë që bërtasin për të, më shumë janë marrë me njëri-tjetrin, me luajtjen e rolit të protagonistëve sesa për një kauzë, që i takon Tiranës. Ditët po ikën dhe ndaj saj tashmë po afrohet një fat tjetër. Sikur ta ruajmë dhe ta restaurojmë, do të kishim me çfarë të krenoheshim në 100-vjetorin e Tiranës së sunë. Kurse, arkitektët, po ta dinin ta restauronin si duhet, do të shpëtonin shpirtin e tyre, që në vitet e fundit e kanë shpëtur për lloj-lloj konjukturash. (Miliosao)

P

POEZIA

Një cikël i këndshëm që e përshfaq me të gjithë aftësinë e tij lirikun shqiptar. Si zakonisht temat e tij përfshijnë një hapësirë të madhe dhe kjo tregon pak a shumë dhe shqetësimet e tij qytetare dhe jo vetëm...

Qielli i nëndheshëm

NGA DEMIR GJERGJI

Njeriu:

Bota më bëri me shpirt e me mish.
Pastaj më dha mendjen, të di si ta prish.
'18

KATËR ERËRA

1-Meli (nëna)
2-Derada (nënëbija)
3-Amla (bija)
4- Unë.
- Bijë!
Të thërret jot' ëmë.
- Maaaa!
Të kërkon jot'bijë.
Unë nuk e di se ç'jam:
Gjysh apo fëmijë.
Katër erëra,
Fryjnë e vijnë,
Dashuritë!
1 korrik, '18

MËMË E BIR

Kur rritej ime më,
Unë s'kisha frymë e zë.
Qëlloi një mot i mirë,
U bëmë mëmë e bir.
Sot nëna thellë fle,
Unë endem përmbi dhë.
Dhe qenka kaq e lehtë,
Kjo lojë vdekje-jetë!

DORËSHKRIM

Si të ta nis në dorëshkrim këtë vjershëz,
Me bojën e freskët pikuar prej penës
Dhe shkronjat radhitur me urdhër të zemrës
Si kardiogramin e fundit mbi letër,
Si të ta nis?
Shkenca ende këtu s'ka mbërritur,
Fatqeqësisht!

HAMLET I HARRUAR

I sigurt për zgjimin, përhumbet në gjumë,
Zgohet me frikën, se s'do flerë më kurrë.

JE


Ti je fusha tej, në male,
Çeltinë je, midis korijes,
Je mëngjesi thellë mesnate,
Fundit je, këtej fillimesh.
Heshkje heshje në fund të fjalës,
Dritë ndrit ti, lot për lot.
Etja je, përposh ujëvarës,
Bota, kur s'do ketë botë.
Më je udha për gjithkund,
Unë, përtej meje je.
Je liria që më mund,
Je gjithçka që jam atje!
Je e nuk e di se ç'jam!

ZHGËNJIMI

Fshehur vetes vetëm heshit,
Mister brenda në mister,
As vjet atij, as këtë vjeshtë,
S'i dhe një shpresë, një shenjë s'i merr:
Zhgënjyer keq ai nga ti,
Pasqyrat sheh me neveri,
Si qiell i kthjellët, i pafund,
Kur veten gjen përmbys në llum.

SYRI I NJERIUT

Nën sytë e njeriut, lakuriq kjo botë,
Nga Poli i Veriut, deri në Bangok.
Që nga elefanti, te bacili kok,



T'i fshihen atij, mundohen më kot.
Qeniesh, vendesh, sendesh, honeve të zinj,
Xhunglave, nëndetesh, tutje në asgjë,
Si pshtar zjarrvënës sulet syri i tij,
Zhvirgjeron enigma gjer në ADN.
Pas kobesh kozmike, tërmet e taifun,
Që botën nuk mundën ta venë përfund,
Është syri i njeriut që sulet gjithkund,
Ta ktheje planetin në hi e në shkumb!

PËRMBAJTJE E FORTË

EROTIKE

Fëmijët lënë dërrasën e zezë,
Fshehin shkumësat e bardhë,
Nxjerrin thëngjijtë e zinj,
Vizatojnë në murin përballë,
Figura porno me "lrafe turpe".
Pas murit që vetiu bie,
Një pamje e nxehtë dashurie...
Skenën me seks,
Prindërit e fshehin me pullë të kuqe...

FLUTURIM NË ËNDËRR

Unë po ulem, shkoni ju pata!
Nga poshtë me joshin ç'pata e s'pata.
Ikni, o pata nga dimrat e ftohtë,
Andej nga beharët ia behin mbi botë.
Shkoni, o pata me klithma të trishta,
Mua më presin pista të pista!
Më lini të bie dhe ikni, o pata,
S'më mbajnë më mua as frymë e as flatra.

DRITË E FSHEHTË

Kjo kometë në qiell të qetë,
Nga është nisur, ku do sosë?
Akull ngrin, a zjarr po djeg?
Ç'fat po mbjell nëpër kozmos?
S'di askush asgjë për të,

Veç asaj flurudhe drite,
Ç'është e ç'gjëmë pas po lë,
Tek harbon mes galaktikë?
Heshjtë e verbër, kjo kometë,
Nisur që andej nga ti,
Rend drejt meje ditë e net
Dhe nuk dihet kur do mbërrijë.
Kjo kometë, dritë e fshehtë,
Ardhur tej, nga sytë e tu,
7 yj larg e tej 7 jetë,
Feks në sytë e mi, këtu.

KËTEJE E PËRTEJ

Kjo verë e këtejme, ajo e përtejme...
Dhe shira, dhe akuj në mes.
Ç'të sjell kjo verë sivjetme,
Nga tjetra që vdes në kujtesë?
Të sotmet këtu, të djeshmet ku vanë?
Një natë-greminë i ndan.
Ç'do t'i kërkoje ditës matanë,
T'ia mbillje të sotmes fidan?
Një engjëll-bebush dhe djalli thinjosh,
Një jetë njeriu në skaje i mban.
Ç'do t'i kërkoje fëmijës lëmshë,
T'ia shkudnje djallit me thinja temjan?
Ti, syri me lot, unë, buza me prush...
Dhe ja Big-bengu i puthjes ndërmjet:
Zbret loti, takohet me buzën në gushë,
Si moti me mot, si jeta me jetë.

"FRIKA NGA ATDHEU"*

Atdheut ia ka mbyllur portën nga jashtë
E s'guxon të kthehet sërish, ta hapë,
Ndonëse nëna dergjet brenda dyfish,
Ndonëse lumi ulërin nën urë si bishë,
Ndonëse ylberët janë lidhur fjongo zije,
Ndonëse yllnesha s'del më në bjeshkë e korijë.
Ndonjëherë kalëron ëndrrën,

Shkon e këqyr kyçet e ndryshkur,
Mos po këputen!
Më trim se kaq,
S'e bëri dot nderi.

*) Titull libri i Skënder Buçpapajt.

UDHA

Në mesin e udhës
Hapin e mbaj.
Pyes:
Kush është më larg;
Fillimi a fundi i saj?

PEIZAZH PERËNDIMI

Lëkurë e rëndë, hija e malit...
Lëkurë e njomë mbi dremtitjen e fushës,
E saporrjepur nga trupi i kolmet e drenushës,
Ende i ngrohtë në çaponjtë yjorë te Arushës!

ARDHJA E NATËS

Ra edhe kjo natë...
Gruaja në shtrat,
Burri në mërgatë,
Njihën në baladë.

GJUMI I ZONJËS SË LARTË

Drita e ditës së ngratë, papritur ka rënë
në çark
Qerpikëve, qepallave të saj!
Nata shtrihet sa gjerë e gjatë,
Si zonja e lartë, e vetme në shtrat.
Tani gjithçka mund të jetë gjithçka;
Ishulli i farit të fikur, gjoks i fryrë
virgjëreshe,
Zajet në fundin e ujit, rruzuj të nxehtë
dhembeje,
Kryqi i katedrales, zog i zi mungese,
Lulet mund të mbyllen si mitra të mbjella
shprese...
Gjithçka mund të sundojë gjithkund e
mbi gjithçka,
Për aq sa zgjat në natë, gjumi i zonjës së
lartë, fillikat në shtrat!

KOZMETIKË

Burrat rritin mjekrat,
Për t'u dukur trima në luftë,
Gratë heqin vetullat,
Për t'u shfaqur hijshëm në rrugë.
Pas shëtijesh dhe betejash,
Gratë me frikë prekin mjekrat,
Burrat shohin egër vetullat.

SORKADHJA

Asnjë armë për vetëmbrojtje,
As çataj, as helm e as thonj.
Për syrin, e hijshme,
Për gojën, e shijshme.
Pre i lehtë bishash,
Kurtesha me kurthe kalon!

ROMANCË NË MAJ

1.
Mollë të bryllët vjeshtë të kafshoja dje,
Gështenjë me vile lulesh,
tani je atje.
Dje, ah i shembur isha përmbi ty,
Sot, bli i rënduar me pjalm e me yj.
Të dy kundërmojmë ende dashuri!
2.
Nesër gështenjat do të vishen me gjemba,
Blirët do t'i fikin yjet nëpër rremba.
3.
Pansesër ndër ne do të digjet vera,
Do të shkundet vjeshta,

Dimri do t'i fshehë me blirë e gështenja. Ne do kundërmojmë vetëm dashuri.

PAS-PARA-PASQYRA

-Në zinë e Flutura Açkës-
Këtëj
Drita të bën ty,
Në zi,
Me gjëmën në sy,
Në mes të mesit,
Zot pas qelqit,
Bromuri i argjendit!
Matanë, ai:
Fati i zi,
Në terr-pusi.
Andej-këndeje,
Si nëpër qiej,
Jerini* shenjt,
Shkon e kthen.
Fara i dritës,
Mirosët mitrës!
*) I biri

RONDO ME 7

7 vitet që na ndanë;
7 male në revan,
7 dete uragan.
7 fjalë si Ti
te një fjali.
7 nota ranë
mbi pentagram.
7 ngjyra, botë
te tablotë.
Përmbi fjalë,
Në romanë,
Nëpër ngjyra
U ripamë!
Në 7 ditë, te një javë,
Mbijmë bashkë
Nga një bërthamë.
7...7...7...7...7...7!...

SKENËZ

Në sytë e fëmijëve, fëmijët ishim ne,
Që s'ditëm se ç'bëmë: të pashë a më pe...

FSHEHJA NGA VETVETJA

Ka ende vende sot kjo botë,
Të shkosh e të mos dish ku je,
Mjafton të kyçesh në një kod,
Të mbretërosh sovran atje.
Kërko, se do ta gesh patjetër,
Një guvë, ku hyn e kush s'të nxjerr;
Siç mund të jetë një gënjeshtrë,
Që s'ka rëndësi, se kush e tjerr.
Ka plot enigma galaktika,
Ku mund të arratisesh lehtë,
Pa të kërcënuar frika,
Nga drita që ngado të ndjek.
Kudo ka skuta plot ky Dhë,
Për shembull, thellë në jetën Tëndë,
Te loti yt të lypësh strehë,
Dhe të mos dish mëngjes e mbrëmje.
Pra paska ende vende Toka,
Si eremit të fshihesh paq,
Të rrosh me pinguinë e foka,
Ku shpirti yt aurorat shfaq.
E vetmja gjë që s'e bën dot,
Na genka fshehja nga vetvetja,
Ku as vetmia s'të del zot,
As muret, heshtja dhe as vdekja!

FËMIJËRIA

Ikën etërit,
të vjetrit!
Me baltë e bar u veshën.
Fëmijërinë time,
E morën në kujtime,
Qielli të nëndheshëm

SHËTITJE NË PARKUN

"GARTEN MÜNCHEN"

Kur e ku ka qenë lufta?
Pyes rosat e egra, mjellmat e buta,
Trishtilët e ndritshëm, pëllumba e flutura,
Drurët që shkundin cicërima si fruta,
Ajrin si puthja, barin si lutja,
Speciet e zhdukura, ujëra dhe statuja.
Kur dhe ku ka pasur luftë?
Pyes në s'e di sa gjuhë,
Dhe s'më kupton askush, askurrë.
Një plak, me të dashurën sup më sup,
Më sheh me frikë e shkon me turp...



Fati i mirë i kryeqytetit shqiptar qëndron në largëpamësinë që pati politika shqiptare në vitet '20-'30, dhe në planet dhe idetë e A. Brasini-t, F. di Fausto-s, projektet e B. Morpurgo-s, idetë e një urbanistike integrale që shndërruen një qendër të banueme anonime në një qytet me fytyrë europiane. Çdo regjim i vendos vullën e vet territorit, e ai komunist e rrethoi në danë Tiranën me një arkitekturë industriale dhe e mbushi me pallate pa fantazi dhe pa origjinalitet, objekte që mund t'i gjeje në Sofje, Kiev apo në Astana.

Teatër me teatrën

NGA ARDIAN NDRECA

Deri në vitin 1920 Tirana ka qenë një qytet që, si shumica e qendrave të banueme tek ne, s'ka dëjtë se çka është plani urbanistik. Një qytet horizontal me bahçe, bashkina, kopshte, oborre, ndërtesa dhe ndër të gjitha objektet që mbushnin hapsinën, plepat dhe selvijat ishin ato ma të naltit.

Një mik i huej që jeton tash disa vite në kryeqytet, më pyeste nëse ka ndonjë vepër letrare, që i është dorëzue historisë së letërsisë sonë, që është shkruar në dialektin tiranas? Jo. Nuk ka si me pasë pse deri në vitin 1920 Tirana ka qenë thjesht një qendër e banueme si Peqini, Shijaku e simotra tjera.

Çka mund të mbeste prej një qendre të atillë të banueme? Qerpiçi s'i ka cilësitë e duhuna për me ju dorëzue historisë, bjen fjala si shtëpitë beratase apo gjirokastrite. Shtëpitë me qerpiç të rrethueme me tulla të kuqe janë njiilloj, aq sa "ab una disce omnes" prej njesies i kupton të gjitha. Mbrojtësit e filozofisë së magjës së Tiranës janë thjesht nostalgjikë, e këtë e tregon fakti se sot asnjë sish, edhe prej atyne të flaktëve, nuk shkon me jetue shtëpia me baltë por me beton.

Fati i mirë i kryeqytetit shqiptar qëndron në largëpamësinë që pati politika shqiptare në vitet '20-'30, dhe në planet dhe idetë e A. Brasini-t, F. di Fausto-s, projektet e B. Morpurgo-s, idetë e një urbanistike integrale që shndërruen një qendër të banueme anonime në një qytet me fytyrë europiane.

Çdo regjim i vendos vullën e vet territorit, e ai komunist e rrethoi në danë Tiranën me një arkitekturë industriale dhe e mbushi me pallate pa fantazi dhe pa origjinalitet, objekte që mund t'i gjeje në Sofje, Kiev apo në Astana.

Nostalgjikët do të jenë gjithnjë gadi me amnistue shumë prej ndërtimeve të pothuaj pesë dekadave komunizëm, por asnjë prej tyre nuk asht në gjendje me sjellë motive racionale për një gjë të tillë, mbasi nuk nisen prej një logjike të mirëfillte, por prej kjuimesh e përjetimesh, që sado të çmueme nuk kanë vlerë universale.

Ndoshta pjesa ma problematike e të gjitha qyteteve shqiptare vjen me ndërhyrjet dhe rishkrimin dhunshëm të urbanistikës dhe arkitekturës gjatë viteve të postkomunizmit. Palëvizshmënisë së disa dekadave i pasoi një individualizëm pa ide, shpërthime të pakontrollueme, pa strategji kognitive dhe pa një kontroll racional. Krugët suburbane dhe rrjetit qytetës u mbush me kompozime primitive, të tipit "shtu miell e



shtu ujë", dhe ajo çka asht ma e keqja u dhunue hapsinë.

Hapsina asht frymëmarrje dhe i jep hijeshi edhe shkretënit të vorfnisë, pohonte njihërë Jean Baudrillard. Tek ne, tash sa dekada, i kanë shpallë luftë hapsinës, lulishteve publike, oborreve të shkollave, truareve, rrugëve, vorrezave, parqeve, kodrinave. Hapsina kryesisht asht zanë prej një urbanistike horizontale, pa frymëmarrje, pa ide, pa shije estetike dhe shpeshherë jofunkionale.

Urbanistika dhe arkitektura shqiptare janë kthye në një "pidgin" të shëmtuem kompleks që shumëkënd e ban nostalgjik ndaj shëmtimit të thjeshtë primordial, rural dhe industrial, që mbizotonte kudo ma parë.

Sociologu urban Chombart de Lauwe ka përcaktue një lidhje shkak-pasojë ndërmjet një ambjenti urban të shëmtuem dhe numrit të shtutave që hanë fëmijët.

Rasti jonë e vërteton plotësisht, e shëmtuemja gjeneron dhunë ndaj ma të dobtëve.

E shëmtuemja, si ajo e vjetra si kjo e reja që prodhohet sot, ka idhtarë pafund ndër ne.

E shëmtuemja dhe dhuna: ky asht binomi që na shqron. Kur njena pushon, tjetra punon, e kështu me rradhë.

Por le të marrim dy objekte: sheshin Skënderbej dhe Teatrën kombëtar. Kohët e fundit rreth të dyve ka polemika të pafundme.

Ritmet e ndërtimeve me dhe pa leje, kanë zvogluë hapsinat dhe kanë zhdukë sheshet dhe pjacat. Shqiptarët duket se vëjnë prej agorafobisë. Nganjihërë edhe kur konceptojnë sheshe, plasin derisa të vendosin statuja dhe buste të personazheve të tipit të Çeço Sazexhiu apo Trim Sokolit, muzikanta pa pentagram apo patriot të trafikut të armëve.

Edhe kur e kanë, idenë e simetrisë e kuptojnë si ai që vendoste në banketin e darsmës dy hundështrembit e fisit ngjëtë me një-tjetrit. Për disiplinë dhe shkencë projektimi të territorit, për interpretim dhe ndërthurje të elementave hapsinorë as që bahet fjalë.

Kemi nevojë për sheshe, për t'u takue, për me zgjanue kandin e shikimin, për një thellësi ma të madhe

gjykimit. Një grup studentash kishte ba një anketë dhe kishte dalë se shumicës së atyne që s'u pëlqen sheshi aktual, e motivonin mospëlqimin e tyne me krahasimet me versionet e përparshme të tij, edhe pse i njihnin veç prej sekuençave filmike dhe fotosh. Ky asht niveli.

Objekti i dytë asht Teatri i mbiquejtun "kombtar". Në mbrojtje të tij gjejnë arsye me u ba bashkë si e djathta si e majta ekstreme. Kur këto dy segmente janë dakord me një-tjetrin, arsyeja dhe logjika gjejnë shumë pak hapsinë krijimtare.

Paleta e parë e mbron teatrën me arsyetimin se e asht ndërtime gjatë kohës së fashizmit etj. etj., e dyta me logjikën se aty janë luejt kryesisht kryeprat e realizmit socialist dhe aktorë të papamë kanë deklamue artin e asaj periudhe.

Të dyja arsyet janë të vërteta, por disi të mangëta për me i dhanë dinjitet asaj çka ka tepruë prej një periudhe historike që nuk zuni rranjë, fashizmit, dhe prej nostalgjisë për një art që nuk ishte mirëfilli në shërbim të së bukurës dhe lirisë.

E veçanta e këtyne dy qëndrimeve asht se asnjë nuk mëton se arsyeja e vet asht e vetmja e vërtetë, por, tue fluturue mbi distancën ideologjike që i ndan, secili i lejon hapsinë edhe arsyeve të kundërshtarit.

Për hir të së vërtetës përveç dy grupeve të partizanëve me kahe të kundërt, ka edhe të tjerë që janë dyshimtarë, siç asht shkruesi i këtyne rriadëve, pa nostalgji për të kaluemen, por thjesht prej përvojës së maparshme të shqullimeve të pafundme me territorin urban.

As Rama as Berisha dhe as Basha nuk mund ta kenë ndërgjegjen e qetë pse nuk e kanë të pastër.

Sa krime ndaj territorit janë firmosë prej tyne? Sa leje që kanë përcudnuë vendin kanë firmosë si kryetarë bashkie apo si kryeministra? Sa ndërtime jashtë kushteve teknike, pa minimumin e kritereve antisizmike janë ndërtime nën sundimin e tyne?

Do të mjaftonte kjo që hepërhe, pa ikë prej skenës politikë këta individë pa kredibilitet dhe pa integritet moral, të mos prishej dhe të mos ndërtohej asgjë tjetër.

Historia asht depozitë vlerash dhe borxhesh, historia e këtyne treve, që rreken sa me e shkatërroue e sa me e rufej një ndërtesë të rëndomtë siç asht teatri, asht thjesht një histori borxhesh ndaj shqiptarëve, prandaj asnjë prej tyne nuk ka autoritet moral me ba apo me zha në pikat nevrlogjike të vendit.

S'kemi aq shumë nevojë për teatër sa ç'kemi nevojë për hapsinë, ku të mund të lëvizim shikimin pa e kryezue me të shëmtuemen. Hapsina asht kushti paraprak për me pasë teatër, jo me luejt teatër.

P
PROZË

Autori shpërfaqet me cilësitë e tij të mira rrëfyese dhe me një prozë vërtetë interesante që e tregon cilësinë e narracionit të tij tepër të formuar...

Një kujtim për parkun “tim”, në Gjenevë!

(shkëputje nga libri me titull pune “P. U.”, në përfundim e sipër!)

mëngjeseve
ëndrrat m'i shqyejnë qentë
në mesditë
kolla e vetmisë
zogjtë m'i tremb
mbrëmjeve
kotësia e ditës
agim gashi



NGA BAJRAM SEFAQJ

...këtu, po në këtë vend, mbase pa ndonjë logjikë as arsye madhore e të caktuar, pikërisht në këtë pjesë tregimi, gjithnjë me lejen e Madhërisë sate, ngjis, ngul e mbjell, këtë copë rrëfimi që, mbase nuk ka lidhje më asgjë në këtë udhë, pos që vjen si dekor, faturë, si piktori kur ngre një vijë mavi hije mbi vetullën e portretit të një bukurshije rioshe, gjithnjë duke lozur lojën dritëhije.

Sa lëshoj parkun “tim”, e dal në rrugën, rue de Genève, që është ndër më të frekuentuarat, një mesoburrë ...

... parku “im”, gjendet në pjesën periferike, por, po aq ekskluzive të Gjenevës, Zonjë e Nderuar.

Qilim i shkruar është!

Një copë parajsë mbi (këtë) dhe të shkretët!

Aftësitë, edhe të një shkrimtari shumë të mirë, me fond shumëfish me të pasur dijesh e njohurish, nuk a fuqi ta qes në letër, qoftë edhe një pjesë të imtë të bukurisë së tij.

Përpiqem të nxjerr në dritë disa të dhëna: Emrin e ka “Parc Floreire”. Hapur për publik është nga ora 8 deri në 22. Qenve u ndalohet hyrja.

Në vitin 1902, e ngriti Henry Correve (1851-1959), baba i kopshëve alpine...

Kështu shkruan poshtë bustit tij, derdhur në bronc qe zë vend diskret në këtë hapësirë jo aq të madhe, por të mrekullueshme. Parqet publike, Ti e di mirë Madhëri, thonë se janë mushkëritë e qyteteve të mëdha e të vogla. Rrëfimi për të le të jetë edhe një pushim, një intermexo, një frymëmarrje në këtë rrugë të gjatë tonë të përbashkët.

Ky park, si sumbull, ka edhe “bibliotekën” miniaturale me mbishkrimin “3 Chêne Culturel”.

Ka formën e një kolibe pëllumbash. Raftet janë të mbushur me nja dyqind tituj librash. Si pëllumba të llojlojshëm.

Gjersa pushon nën hijen e lisit mijëvjeçar, mjafton të zgjasësh dorën e të marrësh cilindo libër. Në mos ta lexosh të tërin, atëherë ta shfletosh ngeshëm, derisa të kënaqësh. Sot gjeta kënaqësi në leximin e romanit të shkurtër por tejet të rëndësishëm, best-seller, “Le vieux qui lisait des romans d’amour” (I moshuari që lexonte romane të dashurisë) të shkrimtarit të shkrimtarit të mirënjohur çilean, Luis Sepúlveda (1949). Shfletova edhe dy romane: “Ni vue ni couue” (As pa as dëgjuar) dhe “Douce nuit” (Natë e vakët) të shkrimtares se njohur amerikane, Mary Higgins Clark.

Parku Floreire është si një kopsh mbuluar me lule. Secila rrajë ka emrin e vet. Echinacea purpurea, Linum perenne, Huachera micrantha, Arbis caucasica, Danthus gratianopolitanus, (sa për ilustrim!). Porosia humane vizitorëve: “Jepuni një shans bimëve!”

Në park ka lisa të gjatë, (.e ju o lisat e gjatë (të Shqipërisë) që ju kam ndërmend ditë natë!).

Ka gjelbërim e mugullim boll.

Ka dy livadhe, ku shtrohen dreka e darka si në filmin artistik amerikan “Kafjalli në lëndinë”, apo kështu disi, s’ka rendësi. “Kafjall të Tifanija” e tablosë së E. Manet, piktor francez që inspiroi impresionizmin.

Ka boll ujë që solemnisht rrëshket, sikur rrezohet nga një objekt lapidar miniatural.

Formë kështjelle.

Pastaj ndahet e rrjedh nëpër kanale të hijshme.

Përfundon, papritmas, si ta përpin toka, në gjirin e një objekti tjetër ndërtimor, të hijshëm, po ashtu miniatural. Si një amfiteatër i vocërr dhe tejet i përshtatshëm për orë letrare “xhepi” apo ndonjë tjetër manifestim të vogël kulturor. E të tjera, të tjera.

Mbi pastërtinë, higijenë le të quhet, që mbretëron në këtë kuti, as që duhet ngarkuar e vra mendjen!

Pse futët këtu e në këtë vend rrëfimi mbi parkun, në mos për asgjë tjetër, atëherë për të dëshmuar së letërsia e mirë ka edhe park të mirë. Në “defterët” e saj, ka mjedise dhe ambiente tjera të mrekulluara: për ski e plazhe të përshtatshme. Për sporte dimërore e verore, gjithëvjetore...

*

... po sa dal nga parku, (lidh vjeggën me fillimin e këputur të kallëzimit), ... në rrugën më të gjallë, më të zhurmshe dhe më frekuentuese të Gjenevës, papritmas ndodhë kjo skenë: një mesoburrë i veshur e mbathur cicë, si ia thonë fjalës të rinjtë e kohës, i pashëm, me flokë të shprishur e të derdhur për ballë, kthehet me fytyrë nga një stacion tramvaji, kur si zogj, zbrasin udhëtarët e shumtë. Merr pozë të mprehtë dhe ekstravagante, burri i botës si një tribun i thekur të ishte, dhe ia krisë një fjalimi të zjarrtë. Mjerisht zhurma e madhe, mbyt fjalët e fjalimit. Eh, sikur të kisha një diktofon a mjet tjetër të ndjeshëm teknik dhe sa herë t’i vijnë “lutkat”, siç thonë pejanët, zotërisë të hallakatur e të luajtur mëndësh, (bien evidament), t’i regjistronen fjalët që i shqipton, do të dilte një rrëfim i roman, nëse jo edhe aq i mirë, atëherë i veçantë dhe original gjithësi!

Më njëzet e katër maj, asaj buzëmbërmje kthej përsëri në “parkun tim”, jo për kendellje e pushim, por, për lamtumirë njëherë e përgjithmonë!

*

Mos të qitet pas mëndësh, parqet e bukura e kanë edhe një të keqe: kur bën mot i keq, boshatisen dhe marrin pamje pikëlluese.

Si ditën kur ia lash lamtumirën për këtë vit. Ndoshta përjetë.

(Gjenevë, maj 2018 vit)?



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri iu dedikua shoqësitimit kryesor, që ka parashtuar organi ynë përballë qeverisjes së tanishme. Destinacioni i ri i "Piramidës" për të qenë Biblioteka Kombëtare dhe jo qendër inovative. Redaktori e mbuloi vetë shkrimin kryesor me qëllimin e madh që të mundet të shpjerë sa të mundet zërin para. Ka pak mbështetje, pasi në masë njerëzit janë të ngërthyer në problematikën e Teatrit Kombëtar dhe përçarjen e madhe të komunitetit teator. Për fat të keq, shiu dhe zjarri, që kanë qenë aq të afërta me Bibliotekën Kombëtare kohët e fundit por edhe bjerrja e sallave të këtij institucioni kanë sjellë si rast imediat, që ai të propozojë si vend strehimi vetë Piramidën. "Të paktën tashmë është harruar ajo habia që do krijonte Kulla e Bibliotekës brenda muzeut, tekta Piramida me hapësirat e saj arkitektonike, por edhe me aksesoret shtesë mund të bëhet një vend që të jetë destinacioni i dekadave të ardhshme të këtij institucioni. Bibliotekës i takon si institucion, një godinë që të përligjë nderin e Shqipërisë dhe asaj që fjala shqipe ka dhënë për ekzistencën e shqiptarëve", shkroi ai në këtë numër.

Po ashtu, në këtë numër, kishim një cikël poetik të Arian Lekës, që ishte punuar me shumë kujdes nga autori dhe që i bënte nder "Milosaos". Në fakt, kishte ardhur që një javë më parë, porse redaktori e shtyu për këtë javë. "Ky është një cikël i ndërtuar mes një urimi dhe një mallkimi detar, si forma politonike dhe monodie të autorit që sjell një fillad interesant të poezisë bashkëkohore shqiptare. Gjendja poetike, me jo

pak nota epike, përcjell disi paradoksin shqiptar të çerekshkullit të fundit...", shkroi ai. Tregimtari Kujtim Dashi është rikthyer pas shumë kohësh dhe autori i la vendin e dulur për rrefimin e tij. Autori shquhet për humorin dhe sidomos përshatjen e fabulave të ndryshme nga jeta në disiplinën e letërsisë. Dashi është simpatik në humorin e tij dhe nuk e ka bezdisur kurrë redaktorin me kërkesat e tij, duke e lënë të lirë të botohet në momentin e caktuar.



Në kuadrin e një lajmi, redaktori shkroi për edicionin e VIII të Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë (B3F), organizuar nga Art-Im-Pulse, i vetmi aktivitet kulturor ndërballkanik në Shqipëri. Ashtu, si ndodh për çdo vit, në këtë aktivitet marrin pjesë me qindra artistë nga të gjitha vendet e Ballkanit. Duhet thënë se gjatë këtij edicioni do të projektohen 75 filma të gjinje: metrazh i gjatë, i shkurtër, filma eksperimentalë, filma të animuar... Të shohim realisht sesa organizatorët do t'i përgjigjen nivelit që presin spektatorët.

U vazhdua sërish me vizatimet e Maks Velos dhe një pjesë lirike nga vendlindja e tij Parisi, me kujdesin e zakonshëm të autorit dhe dëshirën për të sjellë perceptimet e sakaqta të tij. I veçantë për redaktorin ishte një punë me karbon një ndonjë mirëfilli e artit të vet, që ai i kish kushtuar Parisit.

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë dhe tepër qartë e organizuar, por pa shumë pjesëmarrje, paqka se mungesën e emrave autori e kish mbushur me shumë lajme dhe përfaqësimin e Festivalit të Pogradecit.

Autori na sjell një përshkrim të punëve të Solzhenicinit në shqip dhe mënyrën sesi është përcjellë ai në Shqipëri e Kosovë


PËRKTHIMI

Solzhenicini në shqip

NGA KUJTIM MORINA

Solzhenicini është botuar në shqip që në fillim të viteve '90. Më përpara as mund të mendohej sepse edhe në Rusi ose Bashkimin Sovjetik, ai është botuar vetëm në vitin 1989. Fillimisht shtëpia botuese "Buzuku" ka botuar romanet "Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit" dhe "Pavioni i kancerozëve" të përkthyer nga Lili Bare. Më pas është botuar "Arkipelagu Gulag në vitin 2012 nga shtëpia botuese "Princi" në Tiranë, romani "Pavioni i Kancerozëve" në vitin 2014 nga shtëpia botuese "Fan Noli", dhe më tej po kjo shtëpi botuese ka botuar në vitin 2015, "Një ditë e Ivan Denisoviçit" në vitin 2015, "Shtëpia e Matronës" më 2016, dy volumet e para të romanit epope "Rrota e Kuqe - Gusht 1914", 2018, të gjitha këto të përkthyer nga mjeshtritërisht nga Nikolla Sudar.

Vepra e parë e Solzhenicinit në Rusi, "Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit" u botua në disa numra të revistës voluminoze "Novi Mir" rreth 10 vjet pas vdekjes së Stalin-it, në nëntor 1962. Lideri i atëherëshëm komunist Hrushovi e mbrojti këtë botim në frymën e dënimit të krimeve staliniste. Lexuesi rus e mbajti frymën të shihte anën tjetër të medaljes të realitetit dhe të një letërsie jashtë frymës mbisunduese të realizmit socialist. Ky roman i shkurtër përshkruan një ditë të vetme në jetën e një zdrukthetari të kapur në rrjetin e fshehtë të Bashkimit Sovjetik të kampeve skllavëruese të punës ku vdekja nga uria, i ftohti i hidhur dhe dënimet e regjimit të punës ishin bërë të zakonshme dhe ku siç thuhej jetëgjatësia mesatare në këto kampe nuk e kalonte një ditëm. Në atë kohë, Solzhenicini punonte si mësues matematike në një provincë pasi kishte kaluar 8 vjet në burgjet dhe kampet e punës dhe tre vjet në internim. Kjo veper e shkurtër tronditi Bashkimin Sovjetik dhe mbrast botën. Besohet se si veper e parë që e bëri të njohur shkrihtarin botërisht ndikoi edhe stili i tij letrar, autori përshkruan një ditë të mirë të një të bur-



gosuri në kamp, me pak frustrim apo akuzua dhe pa përgjithësimin intelektual, historike apo morale në sfondin e vuajtjeve të tmerrshme dhe metodave të Stigurimit në kamp që merrnin shumicën absolute të kohës.

Më tej do të vinte "Pavioni i Kancerozëve" një veper voluminoze, një roman gjysmë-autobiografik, të cilën autori e përfundoi më 1966. Ky roman qarkulloi për dy vite në dorëshkrim siç ndodhte me librat e ndaluar e të censuruar që qarkullonin fshehurazi dhe madje edhe rishkruheshin me shkrim dore mes shkrihtarëve e lexuesve më të devotshëm dhe pastaj u botua në Perëndim në vitin 1968 në gjuhën ruse dhe më tej në gjuhë të tjera. Në këtë roman përshkruhet jeta e pacientëve në një spital onkologjik në Kazakistan më 1955, dy vjet pas vdekjes së Stalin-it. Autori i romanit si gjithnjë operon me një galeri personazhesh por dy kryesorët janë: Oleg Kostoglotov, ish pjesëmarrës në luftë i cili kishte kaluar vite në kampet e punës si "kundërrivolucionar" përpara se të internohej në Azinë Qendrore sipas nenit të atëherëshëm 58 dhe Pavel Nikollajevich Rusanovit, personazhi i të cilit është rezultat i shkriarjes së dy tipave të ndryshëm, të një punonjësi të rëndësishëm të Min-

istrisë së Punëve të Brendshme dhe të një sekretari partie në shkollë. Ky personazh jo vetëm është konformuar me regjimin por edhe i ka shërbyer atij duke denoncuar bashkëjetëtarët e tij për shkelje të parimeve të solidaritetit proletar apo të abuzimeve me pronën socialiste. Meditimet e personazheve janë gjithandej të pranishme në libër, ç'do të bëhet tani me disa ish të burgosur dhe të internuar që po kthehen në vendbanimet e tyre, do t'i rimarrin sh-

Solzhenicini në shqip

Solzhenicini është botuar në shqip që në fillim të viteve '90. Më përpara as mund të mendohej sepse edhe në Rusi ose Bashkimin Sovjetik, ai është botuar vetëm në vitin 1989. Fillimisht shtëpia botuese "Buzuku" ka botuar romanet "Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit" dhe "Pavioni i kancerozëve" të përkthyer nga Lili Bare. Më pas është botuar "Arkipelagu Gulag në vitin 2012 nga shtëpia botuese "Princi" në Tiranë, romani "Pavioni i Kancerozëve" në vitin 2014 nga shtëpia botuese "Fan Noli", dhe më tej po kjo shtëpi botuese ka botuar në vitin 2015, "Një ditë e Ivan Denisoviçit" në vitin 2015, "Shtëpia e Matronës" më 2016, dy volumet e para të romanit epope "Rrota e Kuqe - Gusht 1914", 2018, të gjitha këto të përkthyer nga mjeshtritërisht nga Nikolla Sudar.

tëpitë e tyre që ua kanë zënë të tjerët, do t'i denoncojnë apo sulmojnë bashkëpunëtorët e sigurimit që i kanë rrasur në burg për sajesa e shpifje të paqena, si mund të bashkëjetojnë ata në një fshat a në një lagje, etj. Personazhet janë në zgrip të ekzistencës njerëzore dhe e ndërthurur kjo me formimin e tyre dhe karakteret e ndryshme jep një botë me të vërtetë interesante. Ka edhe shumë kapituj apo fragmente ku mbizotëron dashuria njerëzore, humanizmi i madh që e karakterizon këtë autor në të gjitha veprat e tij. Për Solzhenicinin është thënë se vepra e tij karakterizohet nga "ruajtja e shpirtit njerëzor në kushtet e totalitarizmit dhe kundërvënja e brendshme ndaj tij, mbështetur në idealin liberal fetar".

Më 1970, pasi ishte hapur sipari me botimin në Perëndim të romanit "Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit" dhe "Pavioni i kancerozëve" erdhi gimi Nobeli i autorit që ai s'mundti të shkojë ta merrte vetë por u shpreh në fjalën që e dërgoi për ta mbajtur në ceremoninë e dhënies së cmimit në Stokholm se 'një fjalë e vërtetë mund të kundërballojë gjithë botën'.

Më tej vjen botimi i "Arkipelagut Gulag" në vitin 1973 jashtë Rusisë, që konsiderohet kryevepra e Solzhenicinit. Arkipelagu është

një paraqitje shumëplanëshe e kampeve, burgeve, qendrave tranzit dhe policisë së fshehtë e regjimit komunist. Ky libër bazohet në dëshmitë e rreth 200 të mbijetuarve dhe në kujtimet e 11 viteve të Solzhenicinit në kampet e punës dhe në internim. Vepra u botua në tre vëllime por siç është shprehur autori "edhe kur përgatija këtë version të fundit, unë nuk e kam parë asnjëherë të plotë librin së bashku, nuk e kam pasur të gjithë materialin e librit mbi tavolinë në të njëjtën kohë" ngaqë pasi i përgatiste kapitujt e veçantë i përcillte fshehurazi jashtë vendit nga frika e policisë së fshehtë duke mos besuar deri në fund se vepra do të botohej e plotë. Gulagu, që ka hyrë edhe në fjalorin e gjuhës angleze dhe që përbëhet nga inicialet e administratës së përgjithshme të kampeve, siç e përkufizon Solzhenicini është "grirësi i mishit njerëzor" (human meat grinder). Pa hyrë në shifra se sa miliona njerëz u ekzekutuan apo vdiqën nga uria, të ftohtit apo kushtet e punës në burgjet dhe kampet e Bashkimit Sovjetik, mund të themi se Arkipelagu është vepra e parë e plotë që sjell me fakte barbaritë e regjimit komunist, një sistem që sipas autorit s'mund të funksionojë sepse është në kundërshtim me karakterin njerëzor dhe sipas tij po e shkatërronte Rusinë dhe vendet e tjera ku ishte instaluar. Ka një kapitull tek Arkipelagu ku Solzhenicini kritikon edhe periudhën e sundimit të Hrushovit, i cili e kishte mbështetur por ai ishte në fund të fundit për revizionimin e regjimit por jo për ndryshimin e tij. Në shqip, Arkipelagu është përkthyer nga anglishtja, marrë nga një botim në SHBA më 1989, ku përzgjidhen pjesët më interesante të librit në një vëllim, me bashkëpunimin e autorit.

Regjimi sovjetik që pas rënies së Hrushovit po merrte hapa mbra-pa, e pa se s'mund ta frenonte shkrihtarin e madh, veprat e të cilit po qarkullonin fshehurazi brenda Rusisë dhe po botoheshin jashtë duke u shpërndarë në miliona kopje dhe vendosi t'ia heqë shtetësinë dhe ta dëbojë shkrihtarin në

V

VIZATIM

Ky cikël i kushtohet Amedeo Clemente Modigliani (12 korrik 1884 - 24 janar 1920) në prag të përkujtimit të ditëlindjes së tij. Maks Velo e ka përcjellë piktorin dhe skulptorin italo-hebre, përmes veprës së tij, në një cikël përsiatjesh, realizuar pikërisht në Francë, vendqëndrimin e piktorit të njohur. Modigliani njihet për portretet e realizuar në një stil modern të karakterizuar nga tejzgjatja e fytyrave, qafave dhe detajeve të tjera fizike, punë që nuk u pritën aq mirë në të gjallë, por më vonë u vlerësuan maksimalisht, sidomos pas vdekjes së tij. Ai vdiq në moshën 35 vjeç në Paris për shkak të tuberkulozit.




→ Vizion nga faqja 19

Solzhenicini në shqip

Gjermani në vitin 1974. Thuhet se fillimisht pati një inskenim për ta vrarë por me që nuk u arrit, atëhere u vendos dëbimi i tij. Autori nuk qëndroi shumë në Gjermani e Zvicër por emigroi në Amerikë ku siç thuhet në periudhën 1974-1991 u mor me romanin voluminoz "Rrota e Kuqe" në 10 vëllime, dy nga të cilat sapo janë botuar në Tiranë nga shtëpia botuese Fan Noli. Autori ka një stil të zhdërvjedhët, një dialog të këndshëm e të kursyer, siç thamë operon me shumë personazhe dhe i pranëve kontekstist historik të veprave, stilin e tij letrar me përshkrime të paharrueshme të natyrës e karaktereve njerëzore duke depërtuar në botën e tyre të brendshme dhe me një humor të hollë. Përkundër Arkipelagut që siç thotë autori nuk ka emra të trilluar personazhesh apo ngjarjesh, vjen Pavioni i Kancerozeve, për mendimin tim, kryevepra e tij artistike ku autori e tregon talentin e tij letrar në përshkrime të gjalla të situatave tronditëse por edhe të momenteve shumë prekëse ku ndërthet e bukura me të shëmtuarën, mirësia me gënjeshtërinë, apatia me dëshirën për jetën, humanizmin dhe mizoria njerëzore.

Pas ndryshimeve demokratike, Solzhenicini kthehet në atdhe më 1994. Ai nuk pranon një çmim të madh letrar nga Jelcini duke shprehur zhgënjimin e tij në pozitën në të cilën kishte rënë Rusia qoftë në planin e brendshëm ashtu edhe për humbjen e influencës në botë. Solzhenicini njihet edhe për kritikën e tij për sistemin perëndimor që ai i ka shprehur hapur edhe kur jetonte në Amerikë. Më tej, megjithë përkrahjen prej tij të politikës së



Presidentit Putin që nga viti 2000 derisa ndërroi jetë më 2008, ai konsiderohet një autoritet i diskutueshëm në vendin e tij që kishte bërë shumë për demaskimin e regjimit komunist dhe as kritikët më të ashpër në vend nuk hapnin debate me të. Në fund të fundit, besoj se është vepra e shkrimtarit që mbetet.

Solzhenicini konsiderohet shkrimtari më i madh rus i gjysmës së dytë të shekullit XX në vazhdimësi të kolosëve të mëdhenj klasikë rusë si Dostojevski, Tolstoi, Çehovi, Pushkini, etj. Besohet se veprat më të mira ai i shkroi në vitet 55-70 të shekullit të kaluar. Ai e atakon disa herë në veprën e tij Maksim Gorkin që megjithëse e vlerëson si shkrimtar të madh, nuk ia fal propagandën e pakursyer për regjimin dhe faktin që ai u vu në radhën e parë të shkrimtarëve apo u bë instrument i regjimit për hyjnzimin e tij.

Solzhenicini është kritikuar

shumë herë nga shtypi perëndimor për mbështetjen e tij ndaj politikës së Putinit. Në fund të fundit, ai është një shkrimtar që e do vendin e tij dhe nganjëherë rrëshqet edhe në deklarime nacionaliste që i krijojnë përplasje të ndryshme. Me Arkipelagun dhe veprat e tjera, ai tregoi se një regjimi të tillë shtypës, i duhet dalë përballë për ta demaskuar botërisht por nuk vë



Kthimi në atdhe

Pas ndryshimeve demokratike, Solzhenicini kthehet në atdhe më 1994. Ai nuk pranon një çmim të madh letrar nga Jelcini duke shprehur zhgënjimin e tij në pozitën në të cilën kishte rënë Rusia qoftë në planin e brendshëm ashtu edhe për humbjen e influencës në botë. Solzhenicini njihet edhe për kritikën e tij për sistemin perëndimor që ai i ka shprehur hapur edhe kur jetonte në Amerikë. Më tej, megjithë përkrahjen prej tij të politikës së Presidentit Putin që nga viti 2000 derisa ndërroi jetë më 2008, ai konsiderohet një autoritet i diskutueshëm në vendin e tij që kishte bërë shumë për demaskimin e regjimit komunist dhe as kritikët më të ashpër në vend nuk hapnin debate me të.

me faj për këtë popullin rus dhe kur sheh se vendi i tij fillon ta marrë veten ekonomikisht dhe politikisht, edhe ai e mbështet pavarësisht nga kundërshtitë. Kështu e vlerëson Solzhenicini si shkrimtar të madh duke e konsideruar atë "figurë kolosale të shekullit, një shkrimtar emancipues në shkallë planetare, ku vepra e tij rrezatoi gjërësisht. Ka qenë një shkrimtar i pakrahueshëm në demaskimin e krimeve të Stalinin, një proces që ende vazhdon sot në botë me dënimin e krimeve të komunizimit." Duket se të dy shkrimtarët kanë gjëra të përbashkëta në qasjen e tyre ndaj letërsisë, politikës, kombit të vet, etj. Dua të kujtoj këtu, dy ese të njohura të Solzhenicinit "Mos jeto me gënjeshtër" (Live not by lies) dhe "Marshi i hipokritëve" të cilat

mund të gjenden edhe në anglisht në internet. Në të parën, shkrimtari thotë që nëse me vetëdije nuk bëhemi shërbyes të fallcitetit të paktën të mos shkruajmë apo firmosim asnjë frazë që shtrembëron të vërtetën, të mos bëhemi agjitorë të politikës së ditës, të mos ia lejojmë vetes të marrim pjesë në demonstrime apo takime kundër vullnetit tonë, etj. Ndërsa në esenë e dytë "Marshi i hipokritëve" autori sjell shembuj e kritikon qasjet me shumë standarde të politikës ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve në botë.

Përkujtimi apo nderimi që i bëri Kosova dhe Shoqata e botuesve kosovarë Solzhenicinit me rastin e 100 vjetorit të lindjes dhe 10 vjetorit të vdekjes është nderim edhe për veten e vet si një vend i lirë. Megjithëse është fakt se Solzhenicini është shprehur kundër ndërrhyrjes së NATO-s në Kosovë dhe deri diku edhe kundër pavarësisë, vepra e tij është një monument kundër shtypjes njerëzore, kundër totalitarizmit, nga e cila Kosova dhe populli shqiptar kanë vuajtur aq shumë. Natyrisht se vepra e një autori mbetet ndërsa deklaratimet për politikën e ditës përgjithësisht harrohen. Dëshiroj të falënderoj shoqatën e botuesve të Kosovës për ftesën në panair për të marrë pjesë në këtë aktivitet si përkthyes i Solzhenicinit, me besimin se do të rritet vëmendja ndaj librit dhe ndaj autorëve të mëdhenj që i kanë dhënë shumë letërsisë dhe botës.

Shënime
1. Përkthyes i
"Arkipelagu Gulag".

Opinioni *i* Ditës

Kur të merr koka erë

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

... e veçantë, e lindur si e tillë, atëherë nis rënia. Atëherë prit fundin. Nuk është e kotë shprehja popullore "I ka marrë koka erë". Të të marrë koka erë do të thotë të humbasësh arsyen, të humbasësh kontrollin e vetvetes, duke bërë veprime të mbrapshta, të papërligjura.

Kjo gjë ndodh këto ditë dhe me kryeministrin tonë, ish-djalin e mikut tim. Ngjitja e tij në pushtet ishte pasojë e disa rrethanave të kohës. Mbjajtja e tij e pushtetit për një kohë të gjatë, është rezultante e disa rrethanave të caktuara, plus intelektit të tij dhe interesit të individëve të korrumpuar. Ngjitjen e Edi Ramës në pushtet, e më pas zbritjen e tij, të shpejtë ose të ngadalë, unë e vërej me kujdes, si një fenomen të zakonshëm që përsëritet, në shtete dhe në kohë të ndryshme.

Edi Rama ka pasur edhe raste interesante, të kompromisit dhe të tërheqjes, ndaj dhe nuk e kuptoj dot se përse, në një rast si ky, i prishjes me një urgjencë të paparë të Teatrit Kombëtar, të tregohet kaq i nxituar, kaq i pamëshirshëm, kaq i vendosur, kaq këmbëngulës, kaq i sigurt dhe kaq i shqetësuar për ta miratuar në parlament vendimin e tij personal...Ka një arsye, në mos përfitimi, ka një arsye e cila do vlerësoar me kujdes...Kur diskutohet për prishjen e teatrit ekzistues dhe ndërtimin e tij pikërisht në atë vend ku ka qenë teatri tradicional, ka një arsye të fortë...Të jetë kjo një urrëjtje instiktive për kolegët e tij artistë? Apo një lloj inferioriteti ndaj artistëve të mëhën? Flitet, por është pak e besuar, që të jetë një problem përfitimi marramendës?...Gjithsesi, argument që jepet, se gjoja teatri qenka amortizuar, rrezik shembje, nuk qëndron. Nuk qëndron as fakti tjetër se na qenka një person me mbiemrin Fusha, i cili i ka premtuar Edit diçka, dhe e kundërta, dhe ky tjetri i paska dhënë besën e Kostandinit, për të ngritur teatrin e ri, në qendër të Tiranës, mbi rrënojat e teatrit të vjetër, së bashku me gjashtë kulla, tre prej të cilave do të ngrihen pikërisht në truallin publik, ku ndodhet aktualisht Teatri Kombëtar. Nuk besoj që të jetë besa e dhënë pasi kryeministri ka dhënë shembuj që nuk e njeh institucionin e besës.

...Unë asnjëherë nuk kam mundur ta njoh psikologjinë e milionerëve, se çfarë i duhen një njeriu kuq shumë para, për një jetë të shkurtër...Pra, dhe milionat përjashtohen nga rasti në fjalë...Atëherë mbetet kapricioja e një njeriu të vetëm i cili pasi i ka uzurpuar të gjitha pushtetet, i merr koka erë.

Po pse mor vëlla kërkoni të prishësh një teatër tradicional në qendër të qytetit? Ç'të bëri teatri vjetër ty? Po pse mor burrë nuk prish shtëpinë me gjethe? Po pse mor burrë nuk prish ish-Lidhjen e shkrimtarëve? Po pse mor burrë nuk prish Piramidën? Po pse mor burrë nuk prish Teatrin e Kukullave, apo atë të Operës? Po pse mor burrë nuk prish hotel "Dajtin"? Po pse mor burrë nuk prish Muzeun



Historik? Po pse mor burrë, po pse mor burrë, po pse mor burrë...ta ka dhënë truri të prishësh të vetmin teatër që ka mbetur në këmbë, në vend që të ndërtohet anë e mbanë Tiranës nja tridhjetë teatro të rinj e të mbetesh në histori, jo si Neroni që dogji

Romën, por së paku, si Enveri që ndërtoi rreth tridhjetë teatro në të gjithë Shqipërinë.

Çudia e madhe ndodh kur dëshira e një individ, bëhet dëshirë, zë dhe arsye e një grupi parlamentarësh, të cilëve siç thotë

Çudia e madhe ndodh kur dëshira e një individ, bëhet dëshirë, zë dhe arsye e një grupi parlamentarësh, të cilëve siç thotë populli "U hedh trutë e gomarit". Ky fenomen po...është shumë më i rrezikshëm dhe me pasojë të mëdha. Në rastin konkret nuk do të ishte çudi që kokëfortësia e një kryeministri arrin gjer në atë shkallë sa t'u hedhë trutë e gomarit gjithë deputetëve të kuq, për të prishur Teatrin e vetëm që ka në këmbë, në qendër të kryeqytetit. Më e çuditshme dhe me pasojë është vendimi unanim i deputetëve të Partisë Socialiste...Vërtet kaq larg të ketë shkuar e keqja e një individ, sa të bëhet e keqja e një maxhorance parlamentare për të shkelur mbi ligjet dhe Kushtetutën?

populli "U hedh trutë e gomarit". Ky fenomen po...është shumë më i rrezikshëm dhe me pasojë të mëdha. Në rastin konkret nuk do të ishte çudi që kokëfortësia e një kryeministri arrin gjer në atë shkallë sa t'u hedhë trutë e gomarit gjithë deputetëve të kuq, për të prishur Teatrin e vetëm që ka në këmbë, në qendër të kryeqytetit. Më e çuditshme dhe me pasojë është vendimi unanim i deputetëve të Partisë Socialiste...Vërtet kaq larg të ketë shkuar e keqja e një individ, sa të bëhet e keqja e një maxhorance parlamentare për të shkelur mbi ligjet dhe Kushtetutën?

Për çudinë e të gjithëve, pati vetëm një burrë që guxoi të dalë nga rreshti. Ky ishte ish-kryeministri Pandeli Majko, i njohur për racionalizim në raste të tilla. Duhet të ketë dhe deputetë të tjerë që mendojnë ndryshe, por nuk e patën guximin të dalin nga rreshti. Që toka rrotullohej, përveç Giordano Brunos, e dinin dhe sh-

kencëtarë të tjerë, - thotë poeti Ev-tushenko, në një poezi të tij, por nuk flisnin dot se kishin fëmijë. Kjo gjë duhet të ketë ndodhur dhe me deputetët e maxhorancës të enjten e datës 5 korrik. E ndjenë veten më të privilegjuar në rresht se sa në rolin e Giordano Brunos. Në thellësi të karaktereve të tyre triumfoi pajtimi me të keqen për hir të interesave dhe përfitimit që të jep posti i deputetit. Ka një moment në jetë, thotë Dostojevski, ka një moment, ku njeriu pranon të poshtërohet ose të lartësohet. Ka një çast ku shfaqen karakteret njerëzore...Ka një gardh ose një pengesë që shërben si një provë. Majkua e kapërceu këtë gardh. Majkua e kapërceu këtë pengesë...75 të tjerët jo. Nuk e kam kuptuar kurrë, psikologjinë e mizantropit, të kompromisaxhiut dhe të mediokrit, dhe të zërit unanimit që votoi për prishjen e një teatri në qendër të qytetit...Mundet që t'i kenë mbushur mendjen vetes se po bëjnë një veprim të drejtë, edhe pse të gjithë që prishja bëhet për interesa të mëdha fitimi dhe për kokëfortësinë e një njeriu që, pasi i ka marrë të gjitha pushtetet, i ka ndodhur fenomeni kokëmar-rjes erë... Vendimet në një parti janë unanime, por unanimiteti në këtë rast u shkon vetëm ushtarëve prej plumbi. Një intelektual arsyeton para se të flasë dhe para se të ngrejë kartonin e kuq të turpit. Kjo gjë ndodhi këtë të ënjte me parlamentarët socialistë...Pushteti është një e drejtë për respektimin e ligjeve, por ligjet shkelet vetëm atëherë kur kujtonin se janë mbi ligjin. Ligjet i shkelin vetëm diktatorët. Kujtoni Hitlerin, Ducen, Stalinin...Maon, Enverin, të gjithë këta diktatorë patën kohën e tyre të ngjites, kohën e lulëzimit dhe kohën e shkatërrimit, që i damkosi me vullë e turpit. Në rastin konkret mendoj që kryeministri ynë nuk është i racës së diktatorëve, por, duke shfrytëzuar shumë mangësi të sistemit ai ka kapur karrigen e diktatorit. Kryeministri ynë edhe pse vuan nga grandomania, është hera e parë që, i frikuri nga protesta e opozitës dhe e artistëve kërkon t'i shmanget vendimi personal duke ia fatuar vendimin maxhorancës parlamentare. Ajo që më çudit dhe që më nxit për të reflektuar me këtë shkrim është fakti se si prej asaj maxhorance pati guximin të dalë nga rreshti vetëm një deputet? Një fakt i tillë është i frikshëm, pasi, mund të ndodhë që me vendime të tilla, të përshpejtuara, kryeministrit t'i lindi ideja për të rrafshuar dhe ministritë, dhe ish-hotel "Dajtin", dhe ish-Lidhjen e Shkrimtarëve, dhe Muzeun Historik, dhe Teatrin e Operës...

Opinion i Ditës

Kujt i shërben djegia e mandateve të PD-së?

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... ajo ka marrë peshën kryesore.

Votimi në parlamentin ligjit që i hapte rrugë shembjes së tij, disa nga figurat e grupit të deputetëve të saj bënë një kundërshtim dinjitoz të ligjit, por forca e numrave të socialistëve bëri të vetën. Pas kësaj shumë ndjekës të PD kërkojnë djegien e mandateve. Është e disata herë që e kërkojnë, dhe më shumë sesa rrjedhojë logjike e një lufte të planifikuar politike, është tregues i frustrimit të tyre.

E vërteta është që kjo maxhorancë nuk është aspak mirëkuptuese me minorancën. Hiq ato ligje si ai i dekriminalizimit, të cilat janë miratuar për shkak të presionit ndërkombëtar, për të tjerat maxhoranca nuk ka pasur shumë kuptim, por edhe opozita nuk është se nuk bën marrëveshjet e veta për ato që janë nën rrogos.

Gjithsesi, këtë valë frustrimi, e cila është e disata, Basha është për-pjekur ta kalërojë. Ndoshta për mungesë nuhatjeje politike, e cila duket që i mungon, në vend se t'i çojë në kreshendo, i ka ulur. Mbase është edhe llogaritje forcash. Ka tre vjet të gjatë përpara, të cilat nuk i japin mundësi t'i bëjë dëm Ramën. Por perceptimi është që ka një marrëveshje me Ramën, të cilën nuk e rrëzon dot me disa të shara



nga podiumi i parlamentit. Njerëzit e dinë që ajo është vetëm teatër. Nuk do ta ndihmojë as djegia e mandateve. Aq më pak për një çështje si ajo e teatrit, e cila është shumë sensibil, por bën mirë mos të komandohet nga PD-ja, e cila edhe në raste të tjera ka treguar se i le në mes të rrugës. Ata që e kërkojnë nuk e mendojnë gjatë, por është një rrugë që të çon askund dhe i heq opozitës një dri-

ta të çmuar për t'u dëgjuar siç është Kuvendi.

E megjithatë disa gjëra duhet t'i bëjë, duke filluar nga protestat e tij duhet të jenë pak më agresive. Rama vetëm nga ajo ka frikë. Gjithashtu, duhet të jetë më i kursyer në përdorimin e togfjalëshit "vetëm mbi trupat tanë do kaloni", sepse është tejkonsuumuar.

Dhe të godasë Ramën tek them-

bra e Akilit siç është lidhja me oligarkët dhe plaçkitja e buxhetit. Por tek kjo e fundit duket se ka probleme të mëdha dhe nuk i duhet kërkuar.

Këto janë vetëm disa hamendësime, sepse pak njerëz mendojnë se Basha mund të rrezojë Ramën. Shumica shpresojnë tek vithisja e një pushteti, i cili tashmë qeveris i pakontrolluar.

/dritare.net

HOROSKOPI

DASHI

Pozicionimi i Marsit në lidhje me Saturnin mund bëjë që të lindin dyshime dhe xhelozitë pa arsye. Një sqarim me partnerin do të heqë çdo dyshim. Përpara se të tregoni gishtin nga tjetri, shqyrtojini njëherë ndërgjegjësin tuaj. Mbase edhe ju keni diçka për të fshehur.

DEMI

Edhe pse i dini të gjitha përgjigjet, nuk do të thotë se keni arritur përsosmërinë. Bëni kujdes, përpikuni të mos jeni të sigurt në vetvete deri në tepri. Është më mirë të mos e merrni çdo gjë gjithmonë seriozisht.

BINJAKET

Përpikuni të jetoni më shëndetshëm dhe të keni një stil jete të qetë, për të shmangur stresin dhe trysinë, që po ndikojnë në mirëqenien tuaj. Nuk është e vështirë të bësh aktivitet fizik, por nevojitet të sterocheni për të qëndruar në formë.

GAFORJA

Disa dyshime rrezikojnë që të mos ju lënë të flini i qetë. Por herët a vonë e vërteta del në shesh dhe më në fund do të qetësoheni. Nëse doni t'i jepni fund një lidhjeje që nuk ju përmbush më, mendojeni mirë, me pas veproni.

LUANI

Shmangni thashethemet duke mbajtur një qëndrim miqësor. Falë buzëqeshjes suaj të shndritshme, do t'ia dilni të mposhtni çdo kundërshtar. Sepse të tjerët e vlerësojnë punën tuaj, kështu që jepini, nëse e doni, gjithçka është e mundshme.

VIRGJERESHA

Mund të synoni një objektiv të rëndësishëm dhe keni një optimizëm të fuqishëm, por t'i kesh shpatullat e ngrohta nga fati nuk është e gjitha. Mos u mburrni, por vazhdoni të qëndroni i përqëndruar në veprimtarinë tuaj.

PESHORJA

Pavarësisht se dikush është përpjekur t'ju vërë shkopinj në rota, arrini që ta fatni e të ecni përpara sikur të mos kishit ndodhur asgjë. Mund t'i kishit bërë të kuptonte personit përgjegjës se nuk duhet luajtur me zjarin. Por është e kotë të shohësh mbropa.

AKREPI

Nuk nevojiten shtafje të jashtëzakonshme dashurie, por të paktën bëjani ditur partnerit që e doni me të vërtetë. Mjafton pak për t'ia shfaqur! Mos gjeni justifikime banale për t'u tërhequr pikërisht në çastin e fundit. Nuk ju shkon!

SHIGJETARI

Për të mos lënduar familjarët apo miqtë, jeni duke humbur veçoritë e karakterit tuaj. Ka ardhur koha të gjeni një ekuilibër midis vetes dhe të tjerëve. Çojini përpara me vendosmëri idetë tuaja, nëse jeni të bindur për qenësinë e asaj që thoni.

BRICJAPI

Nëse në të kaluarën jeni tërhequr për të qenë vetëm, tashmë keni dëshirë të zbatoheni në grup, duke pranuar çfarëdolloj ndryshimi. Ndryshojini pikëpamjet tuaja për t'ju përshtatur atyre të partnerit tuaj, nëse nuk janë të njëjta.

UJORI

Jeni të pavendosur. Nuk dini nëse t'i besoni një detyrë të rëndësishme një personi të ri për ta vënë në provë, ose të veproni si gjithmonë dhe të mos rrezikoni. Gjithçka varet nga rëndësia e çështjes në fjalë dhe vetëm nga ju për ta vlerësuar e për të marrë vendim.

PESHQIT

Të rebeloheni ndaj një eprori për të kërkuar që të trajtoheni ndryshe nuk do të sillte asgjë të mirë. Është më mirë t'i kuptoni këndvështrimin, por pa ngritur zërin. Përmbajuni rregullave të vendosura, pasi nuk mund të bëni gjithmonë sipas kokës suaj.

BalkanWeb.com
 AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
 LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
 ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.


MERRNI NË KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NË APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET
 KERKONI NË APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com BW

FALAS

Fjalëkryqi (1)



- 37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
- 38. Ai dhe ajo.
- 40. Një Madame e Maupassant.
- 41. Këshu thirrej Ernesto Guevara.
- 42. Fund ditari.
- 43. Pije piratesh.
- 45. Kush e thotë refuzon.
- 46. Të parat në sondazh.
- 47. Një makinë franceze.
- 48. Fillojnë stafetën.
- 49. Nisin nga fillimi.
- 50. Qan te Turadot.
- 51. Fundi i një samurai.
- 52. Umberto qe shkroi Lavjërësi i Foucault.
- 53. Dalë në krye.

HORIZONTAL

- 1. Steiger aktor.
- 4. Mbetet në fund.
- 6. Ustinov i kinemasë.
- 11. Janë në modë.
- 12. Nuk e shqyen Danielin.
- 15. Një as i Milan.
- 16. Çobani aktore e jona.
- 18. I dyti në kapitull.
- 19. Dy asa në dorë.
- 21. Qe njeriu i parë që u dënuua padrejtësisht.
- 23. Croft e Angelina Jolie.
- 24. Një që mbahet për mondan.
- 25. Para De Janeiro-s.
- 27. Gjysmë tandem.
- 29. Kap ndryshe.
- 30. Gjysmë tatimi.
- 31. Union Stutendor Operativ.
- 33. Wallach aktor.
- 35. Pak spiunazh.


VERTIKAL

- 1. Ajo e tretë u quajt Moskua.
- 2. Në hyrje të odës.
- 3. Me mea për të pënduarin.
- 4. Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshima.
- 5. Jepet për hartim.
- 7. Lindi edhe Cerberin.
- 8. Mbyllin pora.
- 9. Gjysma e ekipit.
- 10. Një inkursion me mig.
- 12. Fillojnë lehtë.
- 13. Eshhtë tretës me zorrë.
- 14. Pak tematike.
- 17. Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.
- 20. Eshhtë ndalim me pranga.
- 22. Shkroi Këngëtarja tullaçe.
- 23. Eshhtë pikë vaji.
- 26. Ndjajnë shtetet.
- 28. Kush nuk ka... s'është njoftuar.
- 32. Poetja e Lesbos.
- 34. Këshu shprehet komisar Rex.
- 36. Fillojnë panikun.
- 38. Një liqen i kripur.
- 39. Inva soprano.
- 43. Inicialet e Altman
- 44. Një fjalë për sipër.
- 46. Të parat në stadium.
- 47. Fillojnë turmin.
- 48. Në hyrje të sokakut.
- 49. Fillojnë nazet


Fjalëkryqi (2)

- HORIZONTAL**
- 3. Një pune... paguhet.
 - 6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.
 - 8. Vincenzo, bomber te Roma.
 - 12. Kufijtë e pritjes.
 - 13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.
 - 16. Demek s'ka kufij.
 - 18. Qe filozofi i shkollës eleatike.
 - 19. Nino, kompozitor i famshëm italian.
 - 21. Eshhtë ai që ka ngrityr krye.
 - 23. Finlanda e... finlandezeve.
 - 25. Mbledh basket separatistë.
 - 26. Inicialet e Prost.
 - 28. Shkroi Cocktail party.
 - 29. Titulli i Alex ferguson.
 - 30. Stile pa kufij.
 - 32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.
 - 35. Unë dhe ti.


- 36. Hoxha që qe arbitër.
 - 38. Eshhtë provë zjarr.
 - 39. Majtas në fund.
 - 41. Agjenci Ajrore Tiranë.
 - 42. Eshhtë partia e Ariel Sharon.
 - 43. Një mund të jetë çiklistik.
 - 45. Të parat në sondazh.
 - 46. E famshme ajo e psherëtimave.
 - 47. Qendër ditore.
 - 48. Një Baba përrallore.
 - 49. Mund të jetë proteste.
 - 50. Në fund të fundit.
- VERTIKAL**
- 1. Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordonier.
 - 2. Në krye të solistëve.
 - 3. Janë poetë si Ungaretti.
 - 4. Ylli më i shndritshëm i Demit.
 - 5. Janë kopjet si delja Dolly.
 - 7. Një pjesë e dimensioneve.
 - 8. Fillojnë muzikën.
 - 9. Parafjala e prejardhjes.
 - 10. Fernando, bomber i Liverpool.
 - 11. Bisha aktore.
 - 12. Ishin ushtarë të Kserkit.
 - 14. Partia Demokratike.
 - 15. Cepat e një ylli.
 - 17. Ylli i baletit.
 - 20. Pak amoralitet.
 - 22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
 - 24. Italia në Internet.
 - 27. Përhapet me frikë.
 - 31. Mund të jetë françeskan.
 - 33. Dëhin pa kufij.
 - 34. Eshhtë lënda për... ratte.
 - 37. Gjysmë sahati.
 - 39. Tatum që qe pianist.
 - 40. Lloj papagalli.
 - 42. Një pikë vaji.
 - 44. Artikulli spanjoll.
 - 45. Në krye të socialistëve.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



SUDOKU

2					5			
		8	1	3				
9		7	5				8	1
	3			6	1		9	
	4				9	6	7	
							2	
				5				2
1		6	2					
3		8						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	9	5	6	8	4	3
9	5	4	3	8	7	6	1	2
6	8	3	2	1	4	9	5	7
2	9	1	5	6	3	4	7	8
5	6	7	4	2	8	3	9	1
4	3	8	7	9	1	5	2	6
7	2	5	6	3	9	1	8	4
3	1	9	8	4	2	7	6	5
8	4	6	1	7	5	2	3	9

Argëtim filozofik

- Çdokush mer atë që negocion. Nëse pret të marrësh atë që ti vlen, në fund do të të bëjnë të besosh se nuk vlen asgjë.

- Dëshpërimi është çmimi që duhet të paguani kur këmbëngulni për një objektiv të pamundur.

- Nuk dua gjërat e mëdha nga jeta, por ato pak që e bëjnë jetën të madhe.




Thënie të mëdura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



- Të thuash lamtumirë, është një nga mënyrat më të dhimbshme për të zgjidhur një problem. Por ndonjëherë është e nevojshme.
- Thonë gjithmonë se koha i ndryshon gjërat, por në realitet duhet t'i ndryshosh ti vetë.
- Sjellja e njeriut rrjedh nga tre burime kryesore: dëshirë, emocion, dhe njohuri.

- gjërat, por në realitet duhet t'i ndryshosh ti vetë.
- - Sjellja e njeriut rrjedh nga tre burime kryesore: dëshirë, emocion, dhe njohuri.

